



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.60

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9527 datë 11.5.2006	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane për realizimin e programit për zhvillimin e sektorit privat, me anën e një kredie ndihme për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe sigurimin e asistencës teknike për to”.....	1671
Ligj nr.9528 datë 11.5.2006	Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa S.P.A. për programin e zhvillimit të sektorit privat, nëpërmjet mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sigurimit të asistencës teknike për to”.....	1689

L I G J
Nr. 9527, datë 11.5.2006

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT, ME ANËN E NJË KREDIE NDIHME PËR MBËSHTETJEN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME, SI DHE SIGURIMIN E ASISTENCËS TEKNIKE PËR TO”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane për realizimin e programit për zhvillimin e sektorit privat, me anën e një kredie ndihme për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe sigurimin e asistencës teknike për to”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4890, datë 2.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E EKONOMISË, DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
ITALIANE, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME,
PËR REALIZIMIN E “PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT ME ANË TË
NJË KREDIE NDIHME PËR MBËSHTETJEN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA E TË MESME,
SI DHE SIGURIMIN E ASISTENCËS TEKNIKE PËR TO”**

Duke pasur parasysh që Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Ministria e Ekonomisë) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Italiane (Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim) të dyja të quajtura tani e tutje “Palë” kanë rënë dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje (tani e tutje të përcaktuar si “Marrëveshja”);

zhvillimi i sektorit privat është një element kyç për rritjen ekonomike dhe sociale të Shqipërisë brenda kuadrit të parashikuar të reformave, që, ndër të tjera, parashikojnë ristrukturimin e sistemit legjislativ, privatizimin progresiv të sistemit ekonomik dhe modernizimin e sistemit bankar;

marrëveshja dypalëshe (2002-2004), e nënshkruar në Tiranë më 9 prill 2002, parashikon një program për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare dhe burimet financiare përkatëse 27,5 milionë euro në formën e kredisë ndihmë dhe 2,5 milionë euro si dhuratë;

Ministria e Ekonomisë, me notën verbale nr.840/1 të 9 shkurtit 2004, ka kërkuar zbatimin e programit të mësipërm për forcimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme vendase (tani e tutje të quajtura “NVM”);

Palët, në notën e cituar më lart, kanë hartuar një “*Concept Paper*”, të firmosur më 11 shkurt 2004, që përshkruan dhe saktëson aktivitetet kryesore për vënien në jetë të Programit, duke lidhur sistemin bankar privat me sistemin e NVM;

në 30 korrik 2004 Komiteti Drejtues i Drejtorisë së Përgjithshme të Bashkëpunimit për Zhvillim aprovoi një kredi ndihmë prej 27.500.000,00 euro dhe në formën e një dhurate shumë të 2.500.000,00 euro për objektivat e përshkruar në Marrëveshje;

për sa më sipër;

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Përmbajtja dhe përcaktimet e Marrëveshjes

1.1 Kjo Marrëveshje përbëhet nga 18 nene dhe 2 shtojcat vijuese:

Shtojca 1 - Përmbledhje e programit

Shtojca 2 - Udhëzime për realizimin e programit dhe menaxhimin e fondeve

1.2 Shtojcat e lartpërmendura janë pjesë përbërëse thelbësore e Marrëveshjes.

1.3 Fjalët dhe shkurtimet vijuese në tekst kanë kuptimin e mëposhtëm:

Marrëveshja – Marrëveshja aktuale ndërmjet Palëve për realizimin e Programit.

AGF – “Albanian Guarantee Fund”, fondi shqiptar i garancisë, i ndërtuar në bazë të një financimi me anë të një kredie ndihme dhënë Qeverisë shqiptare.

Ambasada italiane – Ambasada italiane në Tiranë

AT – Asistenca teknike e dhënë në kuadrin e Programit.

BTP – Bankë tregtare private (ose bankat tregtare private) me seli ligjore në Shqipëri (sipas ligjit shqiptar mbi bankat).

DZHB-Drejtorja e Zhvillimit të Biznesit në Ministrinë e Ekonomisë.

CLSC – “Credit Line steering committee” (organizëm italo-shqiptar i ngarkuar për mbikëqyrjen e veprimtarive).

Donatori – Qeveria italiane

Dhuratë - Fond i vënë në dispozicion nga DPBZH për realizimin e disa përbërësve të Programit.

ETF- “European Training Foundation”, agjenci e BE-së e ngarkuar për realizimin e disa veprimtarive të parashikuara në Program dhe të financuara me fondin dhuratë.

FSMB – “Fund Supervision Management Body”, organizëm i krijuar nga Qeveria shqiptare dhe i ngarkuar me mbikëqyrjen e menaxhimit të fondeve nga kredia ndihmë.

DFR- Drejtuesi i Fondit Rotativ: Institut financiar italian, që drejton në emër të Ministrisë Italiane të Ekonomisë dhe Financës fondet e kredisë ndihmë të parashikuara në Marrëveshje.

Linjë kredie – Fondi, që MESH vë në dispozicion të bankave tregtare private, për përmirësimin e shërbimit të huave afatmesme dhe përmes këtyre bankave, për NVM-të, kualifikimin dhe ndërkombëtarizimin e tyre, mbështetur në vendimet e FSMB.

Palët – Ministria Italiane e Punëve të Jashtme – Drejtorja e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Ministria e Ekonomisë).

MPJI-DPZH – Ministria Italiane e Punëve të Jashtme – Drejtorja e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim.

MESH – Ministria e Ekonomisë Shqiptare.

MFSH – Ministria e Financave Shqiptare.

On Lending Agreement – Marrëveshje ndërmjet MESH dhe bankave tregtare private e pajisur me rregullat e parashikuara, e cila disiplinon përdorimin e linjës së kredisë sipas këtij Programi.

NVM – Shoqëri me të drejta shqiptare të identifikuar si ndërmarrje të vogla e të mesme nga ligji vendas mbi NVM-të.

PMU-“Programme Managment Unit” e ngritur nga qeveria shqiptare për realizimin e Programit.

Programi – Tërësia e ndërhyrjeve të parashikuara dhe të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Project Sub-Loan – Hua e dhënë nga MESH për bankat tregtare private me qëllim financimin e projekteve të NVM.

ARZH – Agjencitë rajonale të zhvillimit të Qeverisë shqiptare.

Subsidiary Loan-Hua e dhënë NVM nga bankat private tregtare e destinuar për projekte të vetme sipas Programit dhe kriterëve të përcaktuara të pranimit.

Sub Loan At- Hua e dhënë nga MESH për BTP me qëllim programet e asistencës teknike të saj.

NJTQ – Njësia Teknike Qendrore e MPJ – DPBZH.

NJTL –Njësia Teknike Lokale e Ambasadës italiane në Tiranë.

Neni 2

Qëllimi i Marrëveshjes

2.1 Kjo Marrëveshje synon të rregullojë realizimin, drejtimin dhe përgjegjësitë e Palëve për zbatimin e Programit të quajtur “Programmi për zhvillimin e sektorit privat nëpërmjet një kredie ndihme për mbështetjen e NVM dhe AT përkatëse”, që do të quhet Programi.

2.2 Me këtë qëllim Marrëveshja sanksionon angazhimin e të dy Palëve në lidhje me Programin, duke vendosur theksin te kushtet e afatet për përdorimin e kredisë, të fondit të Garancisë, dhuratës dhe drejtimit të Programit.

2.3 Programi, një përmbledhje e të cilit paraqitet në shtojcën 1, propozohet të ndjekë objektivat e mëposhtëm:

- Objektivi i përgjithshëm i Programit është të kontribuojë në rritjen ekonomike të Shqipërisë dhe të zgjerojë marrëdhëniet tregtare me BE;

- Objektivi i veçantë i këtij Programi është të zhvillojë sektorin privat dhe të përforcojë NVM, duke u favorizuar kështu hyrjen në sistemin privat bankar.

Neni 3

Angazhimet e Qeverisë italiane

Qeveria e Republikës Italiane e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim, merr përsipër të financojë Programin në shumën e 30 milionë euro e përcaktuar kështu:

3.1 Kredi ndihme prej 27.500.000,00 euro, e cila do të derdhet në dy llogari të veçanta pranë Bankës së Shqipërisë, e ndarë si më poshtë:

3.1.1 25.000.000,00 euro, që do të derdhet në një llogari të veçantë pranë Bankës së Shqipërisë, për krijimin e linjës së kredisë, nga e cila do të përfitojnë NVM për projekte të veçanta nëpërmjet BTP, që nga ana e tyre do të përfitojnë AT, siç parashikohet në shtojcat 1 dhe 2.

3.1.2 Kredia ndihmë prej 2.500.000,00 euro, që do të derdhet në një tjetër llogari të veçantë pranë Bankës së Shqipërisë për krijimin e AGF.

3.2 Dhuratë prej 2.500.000, 00 euro, të ndara si më poshtë:

3.2.1 2.147.000,00 euro për kontributin e destinuar për ETF për të gjitha veprimtaritë e drejtimit të Programit siç paraqitet edhe në shtojcat.

3.2.2 353.000,00 euro të menaxhuara drejtpërdrejt nga DPBZH për fillimin dhe monitorimin e Programit.

Neni 4

Afate dhe kushte të kredisë ndihmë

Kushtet financiare të kredisë ndihmë parashikojnë afatet e mëposhtme:

- Kohëzgjatja: 38 vjet;
- Vlera e interesit: 0.0%
- Periudhë faljeje: 18 vjet.

Mbi bazën e këtyre kushtete financiare, kredia ndihmë parashikon taksën e koncesionit të barabartë me 80.11%.

Neni 5

Angazhimet e Qeverisë shqiptare

Qeveria shqiptare duhet të garantojë zbatimin e Programit në përputhje me Marrëveshjen, do të jetë përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarive e do të ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe detyrat e fillimit të vendosura në “kuadrin logjik” të Programit, ashtu si tregohet edhe në shtojcat 1 e 2.

Qeveria shqiptare merr përsipër të rimburojë shumat e marra me kredinë ndihmë, sipas afateve dhe kushteve të vendosura në nenin 4.

Neni 6

Strukturat e drejtimit për zbatimin e Programit

Struktura drejtuese dhe modalitetet e realizimit të Programit, siç është detajuar në shtojcat 1 e 2, parashikojnë që:

6.1 MESH do të zbatojë Programin, si dhe do të rregullojë marrëveshjet e nevojshme me entet kompetente, do të nënshkruajë kontratat e kërkuara dhe do të jetë përgjegjës për përdorimin e fondeve dhe kredisë ndihmë, për manaxhimin e fondit rotativ, shlyerjen e kredisë sipas modaliteteve dhe procedurave të vendosura në Marrëveshjen financiare;

6.2 MFSH do të lidhë Marrëveshjen financiare;

6.3 FSMB, i krijuar nga Qeveria shqiptare, me pjesëmarrjen e të paktën përfaqësuesve të MESH, të MFSH dhe BSH, do të ngarkohet me mbikëqyrjen e menaxhimit të fondeve nga kredia ndihmë;

6.4 CLSC do të mbikëqyrë efikasitetin dhe efektivitetin e Programit. CLSC do të përbëhet nga përfaqësues të institucioneve shqiptare që marrin pjesë në realizimin e këtij Programi dhe nga përfaqësues të MPJI-DPBZH dhe ambasadës italiane;

6.5 PMU do të përbëhet nga personeli i MESH, do të mbetet operative gjatë gjithë kohëzgjatjes së Programit dhe do të ketë si detyrë asistimin e të gjitha organeve të lartpërmendura në drejtimin e Programit, duke garantuar respektimin e procedurave të përcaktuara në Marrëveshje;

6.6 ETF do të sigurojë shërbime AT për drejtimin e strukturave shqiptare, do të ofrojë shërbime auditimi, këshillimi dhe ekspertimi të parashikuara në Program;

6.7 MPJI-DPBZH do të bëjë monitorimin e ndërhyrjes;

6.8 BTP, që do të aderojnë në drejtimin e linjës së kreditit me anë të *on lending agreement* do t'u japin kreditë NVM;

6.9 NVM do të përfitojnë nga huatë e dhëna nga bankat private tregtare nga linja e kredisë.

Neni 7

Përdorimi i linjës së kredisë

7.1 Kredia ndihmë e përmendur në pikën 3.1.1. (Linja e kredisë për NVM) do të përdoret për financimin e projekteve të NVM nëpërmjet një grupi të përcaktuar BTP, me të cilat MESH do të nënshkruajë një *“on lending agreement”*, si tregohet në shtojcat 1 dhe 2.

Linja e kredisë për NVM do të duhet të financojë marrjen e lëndëve të para, mjeteve, teknologjive dhe AT përkatëse, mirëmbajtjen, pjesët e ndërrimit dhe licencat industriale. Linja e kredisë duhet përdorur vetëm për blerjen e mallrave dhe shërbime nga Italia, në përputhje me udhëzimet dhe procedurat e paraqitura në shtojcën 2. Megjithatë, rreth 30% e investimit të kërkuar mund të përdoret për të mbuluar kostot lokale. Kontratat e furnizimit të financuara me anë të kredisë ndihmë duhet të shprehen në euro.

Kredia ndihmë nuk mund të përdoret për financimin e:

- taksave lokale, doganore dhe TVSH;
- kapitalit qarkullues (duke përjashtuar shumat fillestare për fillimin e ndërmarrjes);
- *joint ventures* ndërmarrjeve tregtare dhe financiare të përkohshme;
- investimeve në sektorin e kohës së lirë, prona të patundshme, armatime, droga dhe pije alkoolike, duhan dhe nënprodukte të tij, prodhimit të produkteve të ndaluara për importim dhe eksportim nga vendet e BE-së, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Linja e kredisë do të mund të financojë AT për BTP për krijimin e një shërbimi të brendshëm dhe të standardizuar për analizimin, dhënien dhe drejtimin e huave për NVM sipas Marrëveshjes. Kjo AT duhet të merret nga Italia, në përputhje me udhëzimet dhe procedurat e treguara në shtojcat 1 e 2.

Kredia ndihmë sipas pikës 3.1.2 (fondi i garancisë) do të mund të përdoret në bashkërendim me operacionet e financuara me linjën e kredisë sipas pikës 3.1.1 në mënyrë që të kontribuojë në uljen e garancive të kërkuara nga BTP për NVM, siç tregohet në shtojcat 1 e 2.

Neni 8

Livrimi, menaxhimi dhe kontrolli i kredisë

Linja e kredisë sipas pikës 3.1.1, do të jepet me tre pjesë paraprake, sipas modaliteteve që vijojnë:

8.1 Pjesa e parë prej 5.000.000,00 euro, do të jepet me kërkesë të MESH drejtuar MPJI-DPBZH me përmbushjen e tre parakushteve që vijojnë:

8.1.1 nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të Marrëveshjes financiare ndërmjet MFSH dhe drejtuesit të fondit rotativ;

8.1.2 krijimin e organeve drejtuese të Programit;

8.1.3 përzgjedhjen e shoqërisë së auditimit.

8.2 MESH do të bëjë kërkesën për dhënien e pjesës së dytë prej 10.000.000,00 euro, kur të jenë përdorur të paktën 4.000.000,00 euro nga pjesa e parë. MESH do t'i bashkëngjisë kërkesës një raport të detajuar dhe të verifikuar nga shoqëria e auditimit, i cili do të tregojë vlerën e çdo operacioni. Dhënia e kësaj pjese do të ndodhë pas verifikimit me vlerësim pozitiv nga ana e MPJI-DPBZH dhe drejtuesit të fondit rotativ të këtij raporti, me përjashtim të çfarë paraqitet në pikën 8.6.

8.3 MESH do të bëjë kërkesën për dhënien e pjesës së tretë prej 10.000.000,00 euro, kur të jenë vënë në punë nga pjesa e parë dhe dytë të paktën 12.000.000,00 FSMB do t'i bashkëngjisë kërkesës një raport të detajuar dhe të verifikuar nga shoqëria e auditimit, i cili do të tregojë vlerën e çdo operacioni. Dhënia e kësaj pjese do të ndodhë pas verifikimit me vlerësim pozitiv nga ana e MPJI-DPBZH dhe DFR të këtij raporti me përjashtim të çfarë paraqitet në pikën 8.6.

8.4 Kur MESH të ketë vënë në punë më shumë se 22.000.000,00 euro nga totali i dhënë, atëherë mund të prezantojë një raport të detajuar dhe të verifikuar nga shoqëria e auditimit. Përdorimi i mëpasshëm i shumave që mbeten i nënshtrohet verifikimit me vlerësim pozitiv nga ana MPJI-DPBZH dhe DFR të këtij raporti, përveç asaj çfarë paraqitet në pikën 8.6.

8.5 Me përfundimin e të gjitha operacioneve, MESH do të prezantojë një raport përfundimtar, të verifikuar, nga shoqëria e auditimit. Një raport i tillë duhet të miratohet nga MPJI-DPBZH dhe nga DFR, përveç asaj çfarë paraqitet në pikën 8.6.

8.6 Qeveria shqiptare merr përsipër në mënyrë të pakthyeshme të ritransferojë fondet e dhëna paraprakisht, nëse nuk do të përdoren asnjëherë, në rast se:

8.6.1 kontrolli i ushtruar nga shoqëria e auditimit mbi dokumentacionin kontraktual do të ketë përfundim negativ;

8.6.2 MPJI-DPBZH nuk miraton disa operacione në favor të NVM.

8.7 Interesat e maturuara në llogaritë e caktuara për linjën e kredisë, siç parashikohet në Marrëveshjen financiare, do të mblidhen dhe do të përdoren për financimin e Programit, si dhe shlyerjen e kredisë.

Neni 9

Fondi rorativ

Huatë që do të rimbursohen nga BTP, në bazë të asaj që është vendosur në këtë Marrëveshje dhe në *on lending agreement*, do të formojnë një fond rotativ, i cili do të drejtohet drejtpërdrejt nga MESH që me të njëjtin mekanizëm, do të financojë NVM. Ky fond qarkullues do të mbahet në llogari të veçantë në një bankë të nivelit të dytë.

Neni 10

Fondi i garancisë

Kredia ndihmë, e përmendur në pikën 3.1.2 (fondi i garancisë) do të mbahet në një llogari të veçantë nga llogaritë e caktuara për linjën e kredisë dhe do të jepet me dy pjesë të njëpasnjëshme, sipas modaliteteve që vijnë:

10.1 Pjesa e parë, prej 500.000,00 euro, do të jepet me kërkesë të MESH drejtuar MPJI-DPBZH me përmbushjen e parakushteve të mëposhtme:

10.1.1. Përgatitja e skemës menaxhuese pilote të prodhuar nga ETF (manuali operativ) dhe miratimi i saj nga CLSC dhe nga MPJI-DPBZH;

10.1.2 Krijimi i organeve manaxhuese/drejtuese;

10.1.3 Caktimi i detyrës shoqërisë audituese, siç parashikohet në pikën 8.1.3;

10.2 Kërkesa për dhënien e pjesës prej 2.000.000,00 euro mund të lihet për në fund të fazës pilote dhe pas marrjes së një raporti të detajuar të redaktuar nga MESH dhe të verifikuar nga shoqëria audituese. Dhënia e kësaj pjese do të kryhet pas verifikimit dhe vlerësimit pozitiv nga ana e MPJI-DPBZH dhe të DFR të këtij raporti.

10.3 Qeveria shqiptare merr përsipër në mënyrë të pakthyeshme të ritransferojë në llogari fondet e dhëna paraprakisht, fondet të cilat do të merren si të mospërdorura, në rast se:

10.3.1 kontrolli i bërë nga shoqëria audituese mbi dokumentacionin kontraktual të ketë përfundim negativ;

10.3.2 MPJI-DPBZH nuk miraton disa operacione me garanci huash NVM.

10.4 Interesat që maturohen në llogarinë e veçantë të caktuar për fondin e garancisë, ashtu siç parashikohet në Marrëveshjen financiare, do të mblidhen dhe do të përdoren për financimin e vetë fondit.

Neni 11

Dhënia, drejtimi dhe kontrolli i dhuratës

Dhurata prej 2.500.000,00 euro do të përdoret si vijon:

11.1 353.000,00 euro do të menaxhohen drejtpërdrejt nga MPJI-DPBZH për shërbimet e asistencës teknike dhe monitorimit për aktivitetet e Programit.

11.2 2.147.000,00 euro kontribut për ETF, në mënyrë që të bashkëpunojë me MESH për të gjitha shërbimet e nevojshme që sigurojnë zbatimin e Programit, përfshirë shërbimet e auditimit, sipas shtojcave 1 e 2.

Neni 12
Procedura caktimi

Caktimi i të mirave (mallrave), shërbimeve e punimeve për zbatimin e këtij Programi nga ana e strukturave të drejtimit dhe të ETF, do të bëhet duke ndjekur rregullat dhe procedurat e Bashkimit Europian për ndihmën ndaj vendeve të treta.

Neni 13
Aktivite monitorimi dhe kontrolli

Palët marrin përsipër të realizojnë çfarëdo të jetë e nevojshme për zbatimin dhe arritjen e objektivave të Programit, e të kryejnë një monitorim dhe kontroll të vazhdueshëm mbi përdorimin e fondeve e çdo kusht tjetër të përmendur në Marrëveshje. Veçanërisht, arritja efektive e objektivave do të vlerësohet periodikisht, sipas skemës të treguesve të përfshirë në “kuadrin logjik” të shtojcës 1.

Monitorimi do të kryhet çdo gjashtë muaj, nga MPJI/DPBZh në bashkëpunim me CLSC, sipas modaliteteve të parashkruara në shtojcën 1.

Neni 14
Mosmarrëveshje

Nëse do të lindin mosmarrëveshje gjatë zbatimit të Programit, ato duhet të zgjidhen nga Palët me anë të këshillimit me MESH e MPJI-DPBZH përmes ambasadës italiane.

Neni 15
Pengesa dhe forca madhore

Në rast pengimi të realizimit të Programit nga një forcë madhore (luftë, përmytje, zjarr, tufan, tërmet, konflikte pune, greva, masa të qeverive përkatëse, vështirësi të paparashikueshme në transport ose për shkaqe të tjera) të njohura nga të dyja Palët, ose në rast rreziku ose kushte të rrezikshme për personelin e huaj, do të merren masat e mëposhtme:

15.1 Nëse kohëzgjatja e pengesës së realizimit të Programit është më e shkurtër se 6 muaj, përdorimi i fondeve të paangazhuara pezullohet derisa MPJI/DPBZH të autorizojë rifillimin e aktivitetit;

15.2 Në rast se kohëzgjatja e pengesës së realizimit të Programit është më shumë se 6 muaj dhe më pak se 24 muaj, programi do të ndërpritet. Fondet e paangazhuara do të ruhen derisa të eliminohet pengesa dhe të mbërrijë autorizimi i MPJI/DPBZH për rifillimin e aktivitetit;

15.3 Nëse kohëzgjatja e pengesës është më e madhe se 24 muaj, Palët janë të detyruara të bien dakord për vazhdimin e Programit dhe të vendosin për veprimet e mëtejshme. Në rast të pamundësisë së vazhimit të aktiviteteve, Palët duhet të vendosin mbi destinacionin e fondeve të paangazhuara. Në mungesë të një marrëveshjeje, pala shqiptare merr përsipër të rimbursojë shumat e mbetura;

Në rast se disa projekte hasin nga pengesa për shkak të forcave madhore, të gjitha aktivitetet dhe fondet që lidhen me to, pezullohen deri në heqjen e këtyre pengesave dhe mbërritjes së autorizimit për rifillim të lëshuar nga MPJI/DPBZH. Nëse pengesat vazhdojnë përtej 24 muajve, Palët janë të detyruara të bien dakord për destinacionin e fondeve të mbetura. Projektet e paprekura nga pengesat, do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre dhe sipas disponueshmërisë së fondeve të dhëna.

Neni 16
Denoncimi i Marrëveshjes

Palët kanë të drejtën e denoncimit të Marrëveshjes, nëse verifikohet një nga rastet e mëposhtme:

16.1 Mosrealizim objektivash të parashikuara në Program ose mosparaqitje nga ana e autoriteteve shqiptare të dokumentacionit të kërkuar për pjesët e tjera të financimit;

16.2 Gabime të rënda nga ana e MESH, si për shembull vonesa të pajustificuara dhe të zgjatura (me shumë se nëntë muaj) që mund të kërcënojnë arritjen e objektivave të Programit, përdorimit të fondeve për arsye të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë Marrëveshje dhe në Marrëveshjen financiare, vonesa të tejzgjatura të raporteve të parashikuara;

16.3 Tejzgjatje e pengesave dhe forcave madhore, siç përcaktohet në klauzolat e nenit 15.

Në rast gabimi të rëndë si në pikën 16.2, MPJI-DPBZH e njofton me shkrim për ngjarjen MESH, duke e ftuar këtë të fundit që të marrë masat e duhura brenda një periudhe jo më të gjatë se 90 ditë nga dita e njoftimit. Pas këtij afati, MPJI-DPBZH rezervon të drejtën e denoncimit të Marrëveshjes. Në dy rastet e tjera të lartpërmendura MPJI-DPBZH mund të vendosë, në mënyrë të njëanshme, për denoncimin e Marrëveshjes, duke njoftuar MESH me një notë verbale, të paktën tre muaj përpara. Në çdo rast, pas këtij njoftimi, MESH është e detyruar të ndërprerë aktivitetin e Programit me përjashtim të një marrëveshjeje tjetër midis Palëve.

Në rast denoncimi të Marrëveshjes, Qeveria shqiptare duhet t'i kthejë MPJI/DPBZH të gjitha fondet e dhëna, që nuk janë shpenzuar akoma sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17
Amendamente

Palët mund të propozojnë ndryshime të Marrëveshjes nëpërmjet shkëmbimit të notave verbale. Amendamentet për të cilat Palët kanë rënë dakord eventualisht, do të hyjnë në fuqi sipas procedurave reciproke të brendshme të parashikuara për këtë qëllim.

Neni 18
Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe denoncimi

Secila nga Palët duhet të njoftojë tjetrën me shkrim për plotësimin procedurave vendase të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi nga data e marrjes së njoftimit të tillë të fundit.

Kjo Marrëveshje do të ketë një kohëzgjatje 3-vjeçare nga data e hyrjes në fuqi. Pas një marrëveshjeje mes Palëve, kjo kohëzgjatje mund të shtrihet deri në përdorimin e të gjitha fondeve.

Për sa më sipër e me mirëbesim, përfaqësuesit nënshkrues, të autorizuar rregullisht nga qeveritë përkatëse, kanë nënshkruar Marrëveshjen në fjalë.

Bërë në Tiranë, më 21.6.2005 në dy origjinale, secili në gjuhët dhe shqip dhe italisht. Në rast mospërputhjeje të përkthimit do të ketë epërsi teksti në gjuhën italiane.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë
Z. Anastas Angjeli
Ministër i Ekonomisë

Për Qeverinë e Republikës së Italisë
SHTZ. Attilio Massimo Iannucci
Ambasador i Republikës Italiane

SHTOJCA I PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT

1. Konteksti i kësaj iniciative dhe baza e saj

Kjo iniciativë vjen si rrjedhojë e Marrëveshjes dypalëshe italo-shqiptare për bashkëpunim e zhvillim, e nënshkruar më 9 prill 2002, sipas së cilës MPJI-DPBZH ka marrë përsipër, mes të tjerash, të mbështesë përforcimin e zhvillimit të NVM shqiptare.

Në kuadrin e tranzicionit drejt ekonomisë së tregut, Shqipëria ka realizuar reforma të rëndësishme strukturale, që kanë favorizuar rimëkëmbjen ekonomike dhe konsoliduar procesin e demokratizimit. Procesi i privatizimit ka prekur shumë prej sektorëve të ekonomisë, por konsolidimi i tyre nuk është ende plotësisht efektiv. Në këtë kuadër, risia relative e sistemit kreditues privat dhe e sistemit të ndërmarrjeve të vendit kanë çuar në individualizimin e një programi, më shumë me synimin e ndërhyrjes në mekanizmat ndërveprues ndërmjet subjekteve të ndryshme, që veprojnë në këtë fushë (institucionet publike, shoqëritë e kësaj kategorie, konsulentët, bankat tregtare, ndërmarrjet), sesa të përgatitjes së një mekanizmi klasik investimi të pastër për importimin e mallrave nga Italia. Veçanërisht, mundësia e NVM për të pasur kredi afatmesme/afatgjata pengohet nga eksperiencia e pakët e bankave private tregtare në menaxhimin dhe vlerësimin e formave të tilla të kredive. Rrjeti i dobët i marrëdhënieve ndërmjet këtyre dy sektorëve përjashton sipërmarrësit e vegjël nga rrethi i kredive, i cili shkon kryesisht te grupet e mëdha e të njohura të industrialistëve. Pasojë e mëtejshme e këtij skepticizmi është edhe niveli i lartë i garancive-të nivelit 250%- që kërkohet nga bankat për mbulimin e riskut. Mungesa e këtyre garancive përbën arsyen e përjashtimit të NVM nga mundësitë e realizimit të strategjive të zhvillimit me anë të investimeve të nevojshme.

Me këtë qëllim, kjo strategji e përpunuar propozon të arrijë objektivat e mëposhtëm.

2. Objektivi

Qëllimi i përgjithshëm i Programit është të kontribuojë në rritjen ekonomike të Shqipërisë dhe në përforcimin e marrëdhënieve ekonomike të saj me Bashkimin Europian.

Qëllimi i veçantë i këtij Programi është të mbështesë NVM me anë të ndërhyrjeve që synojnë krijimin e një ambienti të favorshëm për zhvillimin e tyre, duke iu referuar kryesisht sektorit të kreditimit.

3. Financimi

Ky Program parashikon vënien në dispozicion prej 30 milionë euro që ndahen si në tabelën nr.1:

- Një financim dhuratë prej 2,5 milionë euro, i ndarë në dy pjesë: i) një fond ekspertësh në dispozicion të MPJI-DPBZH për asistencën e specialistëve të Ministrisë së Ekonomisë në fazën e fillimit dhe për aktivitete monitorimi periodik; (ii) një kontribut për ETF për realizimin e asistencës, auditimit, si dhe trajnimin për aktorët e ndryshëm të përfshirë.

- Financimi me kredi prej 27,5 milionë euro, edhe kjo e ndarë në dy pjesë: i) një linjë kredie prej 25 milionë eurosh kryesisht për projekte investimi të NVM; ii) dhe një fond i garancisë prej 2,5 milionë euro për të kontribuar në uljen e nivelit të garancive, të kërkuar nga bankat NVM për dhënien e huave.

Financimet italiane të kredisë ndihmë do të jepen me transhe (pjesë) paradhënie në llogarinë speciale pranë Bankës së Shqipërisë. Nga llogaria speciale fondet do të kalojnë në dy llogari (linja e kredisë dhe fondi i garancisë) pranë një banke të nivelit të dytë.

Tabela 1
Skema financiare

Aktiviteti	Përshkrimi	Dhuratë (euro)	Kredia ndihmë (euro)	Totali (euro)
Kualifikimi dhe specializimi i BTP	AT dhe trajnime, kontrata shërbimi ndërmjet BTP dhe shoqërive të specializuara	50.000,00	250.000,00	300.000,00
Linja e kredisë për PMI	AT dhe trajnime, hua afatmesme (industriale dhe bujqësore) nga BTP dhënë NVM	50.000,00	24.750.000,00	24.800.000,00
Linja e kredisë për PMI	AT dhe trajnime, hua afatmesme (industriale dhe bujqësore) nga BTP dhënë PMI	50.000,00	24.750.000,00	24.800.000,00
Fondi i garancisë	AT dhe trajnime, mbulimi i një pjese të riskut komercial me propozim të BTP	150.000,00	2.500.000,00	2.650.000,00
Ndërtimi institucional	AT dhe trajnime, marrje mallrash e shërbimesh, etj.	725.000,00	0,00	725.000,00
Drejtimi i programit (mbështetje MESH dhe PMU dhe shërbime auditimi)	AT dhe trajnime, marrje mallrash e shërbimesh etj.	1.172.000,00		1.172.000,00
Monitorimi	Fondi për ekspertët	353.000,00		353.000,00
Aktiviteti	Përshkrimi	Dhuratë (euro)	Kredia ndihmë (euro)	Totali (euro)
MPJ-DPBZH				
	Totali	2.500.000,00	27.500.000,00	30.000.000,00

4. Rezultatet e pritshme, aktivitetet dhe treguesit përkatës

Kjo iniciativë propozohet që të ketë një sërë rezultatesh të bashkërenduara, që kontribuojnë në krijimin e mekanizmave ndërveprues midis sistemit kreditues dhe atij privat, që përbëhet 95% nga NVM, që do të vazhdojnë edhe kur iniciativa të arrijë fundin. Më poshtë praqiten rezultatet që projekti merr përsipër, veprimtaritë për arritjen e tyre dhe treguesit e verifikimit (shih tabelën 1).

1. Përmirësimi i hyrjes së NVM në shërbimet financiare, duke favorizuar një ndërveprim më të madh ndërmjet vetë NVM e BTP. E gjithë kjo do të favorizojë specializimin e BTP në operacionet me hua afatmesme.

Me qëllim specializimin e BTP në menaxhimin e operacioneve të kredive afatmesme, Programi parashikon realizimin e aktiviteteve që do të krijojnë brenda tyre struktura dhe kompetenca të duhura për kryerjen e këtyre operacioneve. Kështu, BTP të interesuara të bashkohen me këtë linjë kredie mund të përfitojnë nga programet AT dhe trajnimeve të dhëna nga FET dhe nga linjë kredie për krijimin e shërbimeve të veçanta në menaxhimin e kredive afatmesme.

AT dhe trajnimi për BTP që në të ardhmen do të bashkohen në linjën e kredisë

ETF do të ngarkohet të asistojë BTP e interesuara, duke siguruar AT dhe trajnimin e duhur për marrjen e njohurive të nevojshme për menaxhimin e kredive afatmesme. Për këtë, do të vendosen kritere pranueshmërie, të cilat do të respektohen nga BTP, për të marrin pjesë në iniciativë (të tilla kritere paraqiten në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje).

1.2 Mbështetje për kualifikimin dhe specializimin e BTP

BTP që do të duan të marrin pjesë në linjën e kredisë, por që nuk i përgjigjen kritereve të pranueshmërisë (të paraqitura në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje), mund të marrin pjesë në një financim të veçantë me kredi ndihme, ndërmjet 25,000 e 125,000 euro për rregullimin e strukturave përkatëse të drejtimit të huave afatmesme, pranë një banke/shoqërie të specializuar italiane të përzgjedhur nga vetë BTP. Do të jetë detyrë e ETF të përpilojë një manual operativ për vlerësimin dhe menaxhimin e kredisë.

Arritja e një rezultati të tillë do të duket nga numri i BTP, që do të kërkojnë të marrin pjesë në linjën e kredisë, dhe nga rritja që i korrespondon huave industriale të dhëna në fund të Programit.

2. Gatishmëri e lartë kapitalesh për hua afatmesme dhe rritje e mundshme e burimeve financiare për ndryshimin dhe përforsimin e shërbimeve bankare

Kredia ndihmë e parashikuar nga Programi do të vërë në dispozicion të NVM fonde të destinaura për kualifikimin dhe ndërkombëtarizimin e tyre nëpërmjet përdorimit të sistemit bankar privat. Për këtë, një rezultat i tillë do të arrihet me ndërtimin e një instrumenti që do t'u mundësojë NVM të marrin pjesë në kredi me kushte të lehtësuara, dhe do t'u lejojë të hyjnë në kontakt me një sistem bankar gjithnjë e më të përgatitur për t'iu përgjigjur nevojave të tyre të veçanta. Nga ana tjetër, BTP do të mund të kenë burime më të mëdha për përmirësimin e shërbimeve që do t'u ofrohen NVM.

2.1 Ndërtimi i një linje kredie të specializuar për NVM, e dhënë nëpërmjet BTP pjesëmarrëse.

NVM, që do të duan të marrin pjesë në një financim afatmesëm, do të duhet t'i paraqesin një projekt një BTP pjesëmarrëse, të zgjedhur prej tyre. Kriteret e pranueshmërisë sipas projektit dhe sipas vetë NVM do të paraqiten në shtojcën 2. Pas një kërkese të tillë dhe miratimit nga organi vendimmarrës i BTP, bihet dakord me organin drejtues të fondit të kredisë ndihmë-FSMB-dhe për *Project sub loan* të përgatitur më parë. Më pas, BTP do të japin huanë-pas nënshkrimit të huasë-për NVM, në bazë të projekteve të veçanta të paraqitura nga vetë ato (afatet e kushtet, së bashku me elementet procedurale, tregohen në shtojcën 2). BTP marrin përsipër riskun komercial në hua të tilla, të emëruara dhe të livruara në euro, që do të përdoren nga NVM për marrjen e mallrave dhe shërbimeve nga Italia (me një përqindje maksimale prej 30% për t'u shpenzuar në vend).

Një kredi e tillë do të jepet me tre pjesë paradhënie, nga të cilat pjesa e parë do të jetë pilote.

Arritja e këtij rezultati do të duket nga sasia e huave të dhëna në total me anë të projektit (niveli i ekspozimit të bankave afatmesme).

3. Rritje e numrit të NVM si kliente të BTP, nëpërmjet uljes së nivelit të garancive që ato duhet të paraqesin për të marrë hua.

Me qëllim luftimin e faktorëve që pengojnë NVM të hyjnë në kontakt me sistemin kreditues, ky program synon të ulë nivelin e lartë të garancive të kërkuara nga BTP, në mbulimin e riskut të huave të dhëna NVM.

3.1 Krijimi i fondit të garancisë

Për ndërtimin e një fondi të tillë, do të jenë të nevojshme fazat e mëposhtme, që synojnë krijimin e një normative të përshtatshme për disiplinimin e përdorimit dhe verifikimin e menaxhimit të tij. Me këtë qëllim, ETF do të ngarkohet të asistojë MESH në këtë proces. Rrjedhimisht nga lëshimi i një normative të tillë, do të nisë një fazë pilote në bazë të një skeme drejtimi të përpunuar nga ETF dhe të miratuar nga MESH dhe MPJI-DPBZH. Kështu, kur faza pilote të ketë dhënë përfundim pozitiv, fondi i garancisë do të fillojë të funksionojë.

Arritja e një rezultati të tillë do të sigurohet nga treguesit që vijojnë: (a) volumi i huave afatmesme të dhëna NVM, (b) raporti ndërmjet statistikës mesatare të garancisë, i kërkuar për çdo hua, mesatarja e huave (afatmesme).

4. *Institution Building* i sektorit, për të kontribuar në krijimin e një ambienti të favorshëm për zhvillimin e NVM dhe bashkëveprim ndërmjet ndërmarrjeve, BTP, autoriteteve publike e konsulentëve lokalë.

Me anë të ndërhyrjes së MESH, FET do të realizojë trajnime për subjekte të ndryshme që do të shërbejnë për krijimin e një ambienti të favorshëm për ndërveprim midis operatorëve të futur në një sistem modern tregu.

4.1 Trajnimi i funksionarëve të MESH dhe agjencisë shqiptare të NVM

Kjo veprimtari parashikon trajnimin e funksionarëve dhe të stafit të Ministrisë së Ekonomisë dhe agjencisë së NVM. Së pari do të analizohen nevojat për trajnim dhe, në bazë të kësaj analize, do të organizohen kurse të veçanta. Analiza dhe kurset do të kryhen nga një ekip ekspertësh lokalë dhe ndërkombëtarë të koordinuar nga FET. Më pas do të kalohet në fazën praktike të përdorimit të njohurive duke dërguar jo më shumë se 10 nëpunës për një periudhë stazhi pranë ndërmarrjeve dhe institucioneve italiane. Si rrjedhim, do të realizohen vizita studimore në Itali dhe në realitete të tjera ballkanike.

4.2 Ngritja e një sistemi informativ pranë agjencisë për NVM, në bashkëpunim me INSTAT-in.

Ky sistem informativ do të realizohet në bashkëpunim me INSTAT-in shqiptar. Programi parashikon projektimin, realizimin e një *software-i*, vënien e tij në punë, përcaktimin e skedave treguese, trajnimin e stafit menaxhues (INSTAT-i dhe Agjencia për NVM), marrjen e 10 vendeve të punës e fazën e marrjes së të dhënave, duke dërguar mbledhësit e të dhënave në vend.

4.3 Asistencë dhe trajnime për agjencitë rajonale të zhvillimit, dhomat e tregtisë, shoqatat e sipërmarrësve, ndërmarrjet etj.

Gjithë kjo veprimtari propozohet që të sigurojë AT dhe trajnim për agjencitë rajonale të zhvillimit (ARZH) dhe organizata të ngjashme, që do të lindin. Gjithashtu do të përfshihen dhomat ekzistuese të tregtisë. Do të realizohet një program AT dhe trajnime për figurat kyçe të organizatave të sipërpërmendura. Do të sigurohet mbështetje teknike edhe për drejtimin e programit me anë të ndërhyrjeve të shkurtra të ekspertëve lokalë dhe ndërkombëtarë. Më pas do të realizohen ndërhyrje për trajnime mbi tema të veçanta, vizita studimore, asistencë gjatë punës etj.

4.4 Asistencë dhe trajnim për konsulentë lokalë të ndërmarrjeve (agjencitë rajonale të zhvillimit, individëve etj.), për t'i specializuar në përpilimin e *business plan*, diagnostikimit të ndërmarrjeve, *due diligence* etj.

Do të realizohet një program trajnime teorik në Shqipëri për një kontigjent ekspertësh të ARZH-ve, ku do të përfshihen edhe ekspertë privatë. Do të vazhdohet më pas me plotësimin e trajnimit nëpërmjet disa stazhesh operative pranë institucioneve italiane dhe europiane që veprojnë në sektor.

Arritja e këtij rezultati do të duket nga numri i ndërmarrjeve të konsulentëve dhe numri i konsulentëve të trajnuar gjatë programit.

5. Monitorimi dhe vlerësimi

Treguesit e përcaktuar dhe që kanë lidhje me rezultatet e pritshme do të sigurojnë elementet bazë për vlerësimin global të impaktit të programit të NVM përfituese dhe, atje ku është e mundur, në një nivel më të përgjithshëm. PMU do të kujdesen për të marrë informacionin e nevojshëm gjatë kohëzgjatjes së Programit, duke përpiluar një skedë që do të mbushet nga çdo BTP, që menaxhon kredi për NVM.

Monitorimi do të verifikojë që kushtet dhe afatet e treguara në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje nuk i provokojnë probleme tregut. Nëse ndodh kjo, CLSC do të mblidhet dhe do të veprojë në nivelet e taksave të ndërmjetme për riekulibrimin e situatës (shiko tabelën).

Nga rezultatet e monitorimit, që do të kryhet herë pas here e bashkërisht, dhe nga treguesit e dhënë nga ambasada, do të mundësohet marrja e masave rregulluese të nevojshme për mbarëvajtjen e programit.

Gjatë vitit të parë monitorimi do të kryhet çdo katër muaj.

ORGANIZMI	PËRSHKRIMI, PËRBËRJA	DETYRA/PËRGJEGJËSI
Ambasada/UTL		<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrje në CLSC; - Mbikëqyrje e mbarëvajtjes së Programit (duke i sugjeruar MPJI-DPBZH modifikimet dhe shtimet e nevojshme).
BTP	Bankat që do t'u japin kredi NVM	<ul style="list-style-type: none"> - Të marrin pjesë në linjën e kredisë duke kërkuar, nëse është rasti, AT me financim të lehtësuar; - Të kërkojnë futjen e projekteve të NVM në linjën e kredisë e të kthejnë me kushte të lehtësuara fondet e marra.
CLSC	Organizëm italo-shqiptar i përbërë nga tre anëtarë të emëruar nga Qeveria shqiptare dhe dy nga MPJI-DPBZH	<ul style="list-style-type: none"> - Vendos kriteret e pranueshmërisë për BTP që do të marrin pjesë; - Vendos kriteret e pranueshmërisë së projekteve të NVM që do të financohen; - Verifikon që afatet dhe kushtet e huave të jenë të lakmueshme për BTP dhe NVM.
MPJI-DPBZH		<ul style="list-style-type: none"> - Nënshkruan Marrëveshjen e Programit; - Siguron disponibilitetin e financimeve të parashikuara; - Kryen dhënien e fondit dhuratë dhe autorizon dhënien në tre transhe, të kredisë ndihmë; - Verifikon operacionet e përfshira në linjën e kredisë; - Siguron praninë e ekspertëve e specialistëve për fillimin e monitorimin e programit.
ETF	Agjenci e BE që do të asistojë MESH	<ul style="list-style-type: none"> - Kontraktin shoqërorin e auditimit ndërkombëtar për verifikimin e kontabilitetit të çdo operacioni; - Siguron gjithë ekspertizën e nevojshme për aktivitete e AT dhe trajnimet e parashikuara në këtë iniciativë; - Raporton pranë FSMB për realizimin e Programit.
FSMB	Organizëm i ndërtuar nga tre anëtarë të përcaktuar nga Qeveria shqiptare	<ul style="list-style-type: none"> - Mbikëqyr menaxhimin e fondit special të kredisë ndihmë dhe të fondit të garancisë; - Udhëzon për përfshirjen e BTP që kërkojnë pjesëmarrje në linjën e kredisë;

		<ul style="list-style-type: none"> - Udhëzon për verifikimin e transaksioneve që duhen në linjën e kredisë kërkuar nga BTP (verifikon pranueshmërinë); - Verifikon përgjegjshmërinë e çdo kërkesë nga BTP sipas këtyre kritereve.
DFR	Organizëm i përcaktuar nga Qeveria italiane i ngarkuar me nënshkrimin e Marrëveshjes financiare	<ul style="list-style-type: none"> - Jep kredinë ndihmë; - Verifikon operacionet brenda linjës së kredisë; - Mban të informuar si MPJI-DPBZH, ashtu edhe ambasadën, si dhe informon MFSH për livrimin e fondeve.
MFSH	Ministria e Financave Shqiptare	<ul style="list-style-type: none"> -Nënshkruan Marrëveshjen financiare me DFR; - Rimburson kredinë me DFR, siç është vendosur në Marrëveshjen financiare.
MESH	Pala tjetër e programit, në kuadrin e së cilës, në nivel teknik, operon Agjencia e Zhvillimit të NVM, e cila koordinon me ARZH dhe me dhomat e tregtisë	<ul style="list-style-type: none"> - Nënshkruan Marrëveshjen e programit; - Menaxhon Fondin Special nga kredia ndihmë e cila do të mbahet në një llogari të veçantë në një bankë të nivelit të dytë dhe që do të hapet nga MFSH; - Krijon dhe menaxhon fondin rotativ sipas nenit 9 të Marrëveshjes; - Shlyen kredinë nëpërmjet fondeve të gjeneruara nga Programi; - Kryeson aktivitetet e CLSC; - Riintegron në të dyja fondet e veçanta shumat që i korrespondojnë operacioneve që nuk gjykohen të vlefshme nga DFR e nga MPJI-DPBZH; - Bën të disponueshme shumat në kompetencë për zbatimin e Programit; - Paracakton bankën agjente që do të menaxhojë llogaritë e veçanta në Itali
NVM shqiptare	Përfituese të huave të dhëna nga BTB	<ul style="list-style-type: none"> - Rikthejë huatë e marra BTP
PMU	Njësia e Menaxhimit të Programit	<ul style="list-style-type: none"> - Asiston MESH dhe FSMB në realizimin e të gjitha detyrave të dala nga Programi dhe mbikëqyrjen e menaxhimit të linjës së kredisë; - Asiston CLSC dhe MESH në detyrat institucionale përkatëse; -Informon MFSH për përdorimin e fondeve të kredisë, fondeve rotative dhe të ardhurave të tjera të gjeneruara nga Projekti.

Shuma e financimit	Tipologjia	Përfituesi	Caktuar	Për aktivitetin
Shuma: €30 m	Kredia ndihmë: €27,5 mln	MESH	BTP	Kualifikim dhe specializim për menaxhimin e kredisë afatmesme
			për €25 mln	Krijimi i një linje kredisë të specializuar për NVM
			MESH Për €2,5 mln	Krijimi i fondit të garancisë
			MPJ-DPBZH (fondi i ekspertëve) për €353,000	Mbështetje për PMU në fazat e fillimit dhe monitorimit
	Dhuratë: €2,5 mln	MESH	FET (kontribut i destinuar) për €2,147,000	AT për BTP për kualifikimin e menaxhimin e kredisë afatmesme
				AT për MESH për trajnimin e stafit të DZHB, CLSC dhe PMU - Seleksionimi i BTP pjesëmarrëse; - Përpilimi i <i>on-lending agreement</i> dhe i manualit operativ.
				AT për MESH dhe Agjencinë e NVM për: - përgatitjen e kuadrit rregullues ligjor të fondit të garancisë; - përcaktimin e një skeme pilote për menaxhimin e fondit të garancisë, me një studim paraprak mbi integrimin e mundshëm të tij në linjën e kredisë.
				Ndërtimi i një sistemi informativ pranë Agjencisë së NVM në bashkëpunim me INSTAT.
				AT për konsulentë lokalë të ndërmarrjeve (ARZH-ve dhe individëve etj.) për përpilimin e: - <i>business plan</i> ; -diagnostikimit të ndërmarjeve; - <i>due diligence</i> etj.
				Seleksionimi i shoqërisë audituese dhe kostoja e auditimit

SHTOJCA 2 VIJA UDHËZUESE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT

1. FILLIMI I PROGRAMIT

Në këtë fazë, aktivitetet kryesore do të jenë:

1. Nënshkrimi i Marrëveshjes në fjalë për zbatimin e Programit DPBZH dhe MESH;
2. Krijimi i FSMB, CLSC dhe PMU;
3. Nënshkrimi i Marrëveshjes ndërmjet ETF dhe DPBZH;
4. Nënshkrimi i Marrëveshjes financiare ndërmjet DFR dhe MFSH;
5. ETF paraqet planin operativ me miratimin e MESH dhe të DPBZH;
6. ETF përpilon, në marrëveshje me CLSC, TR për garën e përzgjedhjes së shoqërisë audituese;
7. MESH i dërgon MPJI-DPBZH (me anë të amabsadës/NJTL të Tiranës) kërkesën zyrtare për dhënien e pjesës së parë të kredisë ndihmë;
8. Dhënia e pjesës së parë nga ana MPJI-DPBZH;
9. Fillimi i veprimtarive;
10. Paralelisht MESH, nëpërmjet PMU dhe asistencës teknike dhënë ETF, do të përgatisë draftin e Marrëveshjes *on-lending*, duke përfshirë këtu edhe manualin operativ për drejtimin e Programit, gjithashtu edhe marrëveshjet për AT *sub-loan* dhe *project sub-loan*;
11. FSMB, me mbështetjen e PMU dhe me asistencën teknike të dhënë nga ETF, analizon kërkesat e BTP për të marrë pjesë në linjën e kredisë dhe do të identifikojë BTP, që do të marrin pjesë;
12. Nënshkrimi i Marrëveshjes *on-lending*, pasi është dëgjuar CLSC, midis MESH dhe BTP.

2. PARIME PËR DREJTIMIN E PROGRAMIT

2.1 Detyra të BTP

BTP duhet t'i japë MESH, CLSC dhe MPJI-DPBZH autorizimin për marrjen e gjithë informacioneve të kërkuara, duke përfshirë edhe ato sekrete. BTP duhet të rekrutojë çdo vit auditë të jashtëm kompetentë, që do të veprojnë sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe kontabilitetit, të marrë personel të nevojshëm dhe të caktojë burimet e nevojshme për realizimin e Projektit.

BTP do të nënshkruajë Marrëveshjen *on-lending* me MESH, pasi është dëgjuar CLSC.

BTP duhet të respektojë gjatë kohëzgjatjes së programit kriteret e pranueshmërisë.

Nëse, gjatë veprimeve CLSC, do të verifikojë që procedurat operative nuk janë respektuar siç është rënë dakord, pjesëmarrja e BTP në Program do të ndërpritet. Rregullat e ndërprerjes së përkohshme dhe/ose përfundimtare do të përpunohen gjatë fillimit të Programit, siç parashikohet nga manuali operativ (shih paragrafin 1.10).

2.2. Karakteristika të kredive për asistencën teknike të BTP

Asistenca teknike do t'u jepet BTP për përmirësimin e teknikës së tyre bankare dhe/ose pajisjen me sistemet dhe programet e tyre informatike. BTP do të ngrenë (ku të shihet e nevojshme) shërbime të reja të specializuara në kredite afatmesme, që do të konsistojnë në njësitë e vlerësimit të riskut të projektit, që do të operojnë sipas udhëzimeve të përcaktuar në manualin operativ (shih paragrafin 1.10).

Me kredinë e lartpërmendur BTP do të mund të financojnë:

1. Konsulencën e nevojshme për përmirësimin e aftësisë së kryerjes së një dhe korrekte të menaxhimit financiar dhe vlerësimin e riskut operativ;
2. Konsulencën e nevojshme për të dalluar zgjidhjen e duhur të problemeve, që kërcënojnë ose që mund të përkeqësojnë situatën përkatëse financiare ose pasurore;
3. Trajnimin e nevojshëm për përmirësimin e funksioneve bankare, aftësive të menaxhimit të riskut operativ dhe/ose financiar dhe për analizimin e formulimin e planeve të punës, analizën e *cash-flow* analiza e ndjeshmërisë, etj.

4. Investime në lidhje me përmirësimin e programeve informatike dhe përgatitjes informatike në sektorët që merren me vlerësimin dhe/ose menaxhimin e riskut operacional financiar që kanë lidhje me zbatimin e Projektit.

2.3. Projektet e financuara nga BTP

BTP do të bëhen garant që çdo hua të jepet, duke respektuar kriteret e pranueshmërisë për NVM dhe për projektet e veçanta të përmendura në treguesit e paragrafit 4. Pra, dhënia e një “*subsidiary loan*” një NVM do të bazohet në analizën e përgjegjshmërisë së klientit që ka kërkuar kredinë dhe në vlefshmërinë e Projektit. Këto analiza do të zhvillohen nga dy njësitë e përshkruara në paragrafin 2.2 të mësipërm.

FSMB, e asistuar nga PMU, duhet të verifikojë nëse procedurat e vlerësimit të aplikuara nga BTP, janë në përputhje me çfarë parashikohet në manualin operativ.

BTP, para se t’i paraqesë FSMB kërkesën për një *project sub-loan*, duhet ta miratojë atë në organin e saj përkatës vendimmarrës. Kur marrëveshja e *project sub-loan* të jetë nënshkruar nga MESH dhe nga BTP, atëherë ajo mund të vazhdojë me marrëveshjen e *subsidiary loan* me NVM, për financimin e projektit përkatës.

Afatet dhe kushtet e kredive që MESH do të aplikojë për BTP, e që këto të fundit do të aplikojnë me NVM, do të vendosen nga CLSC (i mbështetur nga FSMB), duke vlerësuar me kujdes situatën e tregut monetar. Çdo 6 muaj CLSC do të verifikojë afatet dhe kushtet e të gjitha huave-të emëruara dhe të livruara me euro, duke u kujdesur që të mos krijohen devijime në treg.

3. UDHËZIME PËR BANKAT TREGTARE PRIVATE

Kriteret dhe kushtet e paraqitura në paragrafin 3.1, 3.2, 3.3 kanë karakter tregues, pasi përcaktimi i tyre dhe shpjegimi do të bëhet në hartimin e manualit operativ, dhe në verifikimet e njëpasnjëshme periodike çdo 6 muaj, nga CLSC.

3.1 Skema e kriterëve të pranueshmërisë:

1. Licencë ushtrimi e të paktën 1 viti aktiviteti;
2. Përputhshmëri me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Shqipërisë;
3. Aksione private më shumë se 50%, e vlerësuar mirë nga BSH;
4. Operacionet e mundshme, rezultatet e të cilave mund të modifikojnë “*ownership*” dhe/ose përbërjen e kapitalit, duhet gjithsesi të përmbushin kërkesat e pikës së mësipërme;
5. Përbërja e kapitalit neto duhet të rezultojë e “serisë së parë” (TIER 1 Kapital) për një kuotë jo më pak se 50%. “*Capital adequacy ratio*” nuk duhet të rezultojë më i ulët se 11%;
6. Nivel i duhur likuiditeti, siç kërkohet nga BSH;
7. Ekzistencë e mekanizmave të klasifikimit të asetëve dhe të kredive me risk, që në total nuk duhet të kalojnë 35%, dhe mbajtje e duhur rezervash;
8. Të ardhura pozitive në nivel operativ;
9. Drejtim i kualifikuar, praktika të përcaktuara dhe procedura të shkruara për menaxhimin e riskut financiar/operativ;
10. Auditim sipas standardeve ndërkombëtare dhe kontrole të brendshme;
11. Menaxhim i duhur i sistemeve informative;
12. Një listë projektesh që mund të financohen fuqimisht.

3.2 Përgjegjshmëria e BTP

1. Ndërtimi i një bërthame speciale për kredinë afatmesme (industriale dhe bujqësore) *Medium Term Credit Unit*;
2. Ndërtimi i një njësie të veçantë për vlerësimin e riskut “të palës tjetër” (profili i sipërmarrësit, pagueshmëria etj.) *Risk Analysis Unit*;
3. Detyra për të shlyer kredinë në euro të marrë nga MESH (projekti *sub-loan* dhe AT *sub-loan*);
4. Ngritje e mëtejshme e Programit;
5. Vlerësim i projekteve dhe përfituesve, sipas manualit operativ, i kryer nga dy njësitë e pavarura;

6. Administrim i huave;
7. *Follow-up* teknike/ekonomike e Projektit;
8. Raporte katërmujore MESH-it.

3.3 Kushte

1. Shuma totale e huave të marra vetëm nga BTP nuk mund të kalojë 75% të kapitalit të saj neto, dhe/ose 50% të fondeve totale që ka.

2. Vendimi për të dhënë një hua do të merret nga organi vendimmarrës përkatës i BTP në bazë të analizës së pagueshmërisë së klientit dhe vlefshmërisë së projektit. FSMB do të vlerësojë çdo kërkesë për të siguruar që vlerësimet teknike/ekonomike/operative të projektit të jenë në përputhje me manualin operativ dhe parimet e efikasitetit bankare.

3. Afatet dhe kushtet e *subsidiary loans* të NVM do të vendosen dhe rishikohen periodikisht nga CLSC, sipas parashikimeve të paragrafit 2.3 të mësipërm. BTP do të marrin përsipër riskun komercial duke u angazhuar të kthejnë huatë e marra nga MESH, të rregulluara nga kushtet dhe afatet e vendosura nga CLSC, sipas "*on lending agreement*".

3.4 Procedura

BTP e interesuara për të marrë pjesë i dorëzojnë një kërkesë FSMB, i cili do të informojë CLSC për shprehjen e interesit. FSMB do t'u kërkojë BTP të interesuara informacionet e nevojshme për të verifikuar kriteret e vendosura të pranueshmërisë. BTP pjesëmarrëse duhet t'i vënë në dispozicion të DPBZH, qeverisë shqiptare dhe përfaqësuesve të tyre të autorizuar, të gjitha informacionet e kërkuara, qofshin ato edhe sekrete. FSMB harton një relacion për pranueshmërinë, duke specifikuar nëse BTP është e pranueshme, mjaft e pranueshme, nëse përfiton AT, ose nuk është e pranueshme. BTP e pranueshme vazhdon me "*on lending agreement*" dhe e nënshkruan me MESH.

3.5 Penalitete dhe menaxhimi i riskut në raportet ndërmjet MESH e BTP

1. Nëse BTP nuk respektojnë planin e rimbursimit për çdo kredi, atëherë do t'u nënshtrohen penalteteve që konsistojnë në një taksë të shtuar prej 1,0% mbi interesat e detyrueshme, për gjithë kohëzgjatjen e vonesës. Vonesa e shlyerjes përbën kusht për pezullimin e "*on-lending agreement*".

2. BTP do të derdhin në fondin special të kredisë ndihmë një "*commitment fee*" prej 1,5% në fondet e vëna në punë dhe jo të dhëna brenda një afati maksimal të vendosur (për shembull: 3 muaj).

4. UDHËZIME PËR NVM

Kriteret dhe kushtet e paraqitura në paragrafët 4.1, 4.3, 4.4 kanë karakter tregues dhe do të përcaktohen e shpjegohen më mirë në manualin operativ, dhe sipas verifikimeve të njëpasnjëshme periodike 6-mujore nga ana e CLSC.

4.1 Kriteret e pranueshmërisë

1. Të paktën 65% e kapitalit social i mbajtur nga investues privatë;
2. Ndërmarrjet e regjistruara me qëllim fiskal;
3. Aktivitete në sektorët e fabrikave, ushqimore, agro-industriale dhe shërbime përkatëse, të bujqësisë bazë, me përjashtimet e dhëna në nenin 9.5 të Marrëveshjes;
4. Kredibilitet dhe eksperiencë e provuar në sektorin e veprimtarisë financiare, të ndërmarrjes ose menaxhimit në rast aktivitetesh të reja;
5. Raporti ndërmjet debitit dhe kapitalit të mos kalojë 3:1 (i përcaktuar si debit total, përfshirë edhe huanë, i ndarë sipas kapitalit social).
6. Proporcioni i mbulimit minimal të shërbimit të debitit me 1,25 (i përcaktuar si likuiditet i disponueshëm për neton e shpenzimeve operative, dhe bruto e kapitalit e interesave të detyrueshme, i paraqitur në debitimin total për kapital dhe interesa);
7. Pronarët, aksionerët, drejtorët ose menaxherët e ndërmarrjeve nuk duhet të kenë precedentë penalë;
8. Huatë e BTP do të financojnë investime, riparime ose modernizime dhe/ose rritje të kapitalit qarkullues;

9. Huatë mund të përdoren për të marrë material nga Italia. Megjithatë do të jetë e mundur që një kuotë maksimale prej 30% e huasë totale të përdoret në vend ose në vendet e treta, për furnizimin me makineri dhe lëndëve të para, e për shpenzime mirëmbajtjeje të impianteve të punimeve ndërtimore.

10. Çdo projekt duhet të shoqërohet nga një *business plan*, tabela e bilancit, listë e hyrjeve dhe projekti i *cash-flow*;

11. Projektet duhet të kenë një fitim financiar prej të paktën 15%;

12. Duhet të përmbushin kërkesat ambientaliste të parashikuara nga ligji shqiptar; këto kritere do të përcaktohen në manualin operativ.

4.2 Analizat e kërkuara

Analiza e ndjeshmërisë, përfshirë ndjeshmërinë ndaj ndryshimit të kushteve në tregun e produkteve/shërbimeve, rritjes së kostove operative, rritjes së kostove të lëndëve të para dhe uljes së çmimit të produkteve.

4.3 Kushtet e huasë

1. Do të konsiderohen projektet me vlerë totale nga 50.000 deri në 500.000 euro;

2. Kohëzgjatja e huave duhet të parashikojë periudha kthimi më të gjata se 4-5 vjet, dhe periudha të përshtatshme faljeje, në përpjesëtim me kohën e kthimit;

3. Shtrirja që BTP do të aplikojë mbi normat e interesit për huatë, ndaj përdoruesit të fundit, duhet të bëhet që taksat e përgjithshme të mos rezultojë më pak se 1% e taksave të tregut për huatë e këtij lloji;

4. Këto kushte do të rishikohen periodikisht nga CLSC duke i përshtatur me nevojën dhe kushtet e tregut;

4.4 Pjesëmarrja në risk nga ana e kërkuarit

1. Përfituesit duhet të jenë të gatshëm të japin garanci të mjaftueshme për të mbështetur huanë nga ana e BTP;

2. Kontraktuesit duhet të kenë pjesëmarrje domethënëse në ndërmarrjen përkatëse (të paktën 50%) e duhet të jenë të gatshëm të financojnë me fondet e tyre të paktën 25% të kostos së çdo projekti.

5. ASISTENCA TEKNIKE DHËNË BTP

Kriteret dhe kushtet e përmendura në paragrafët 5.2, 5.3 kanë karakter tregues dhe do të përcaktohen e shpjegohen më mirë në manualin operativ, dhe sipas verifikimeve të njëpasnjëshme periodike 6-mujore nga ana e CLSC.

5.1 Llojet e asistencës

1. Konsulencë e nevojshme për përforcimin e rolit institucional të bankave, që i referohet kryesisht aftësisë së tyre për të identifikuar, vlerësuar, kuotuar dhe menaxhuar riskun financiar e operativ;

2. Konsulencë e nevojshme për të përballur situata që kërcënojnë dhe mund të përkeqësojnë kushtet financiare ose qëndrueshmërinë pasurore të BTP;

3. Trajnim për përmirësimin e funksioneve bankare financiare ose operative të menaxhimit të riskut. Investime të lidhura me përmirësimin e sistemeve informatike përsa i përket aftësisë vlerësuese dhe ose manaxhuese të riskut financiar e operativ;

5. Personeli duhet të jetë në gjendje të analizojë e formulojë *business plan cash flow*, analizën e ndjeshmërisë, etj).

5.2 Kushtet e financimit

1. Hua nga 25.000 deri në 125.000 euro. Sasitë më të mëdha mund të konsiderohen rast pas rastit nga FSMB dhe duhet të justifikohen ashtu siç duhet.

2. Kohëzgjatja: deri 6 vjet, periudhë faljeje 2,5;

3. Norma e interesit: 2% në vit;

4. Këto kushte do të rishikohen periodikisht nga CLSC dhe do të përshtaten sipas nevojave dhe gjendjes së tregut.

5.3 Penalitete

1. Në momentin që BTP nuk respektojnë planin e rimbursimit për çdo hua, atëherë ato do të jenë subjekt penaliteti që konsiston në një normë shtesë prej 1,5%, mbi interesat e detyrueshme, përgjatë gjithë vonesës. Prapambetjet në pagesa përbëjnë bazën për pezullimin e kërkesës për pjesëmarrje. Sa herë që kapitali ose interesat e detyrueshme të huasë vonohen, BTP duhet t'i japë MESH një raport, duke shpjeguar arsyet e vonesës.

2. BTP do të paguajë në *commitment fee* prej 2,5% mbi huanë e marrë të pafinalizuar ende me në kontratë asistence teknike. Një situatë e tillë përbën një bazë për ndërprerjen e pjesëmarrjes.

6. FINANCIMI I PMU

1. PMU do të financohet nga Qeveria shqiptare vetëm përsa i përket vendndodhjes.

2. Programi do të financojë shërbimet dhe pagesat e ekspertëve të PMU.

3. Kostoja relative për pajisjet e zyrës, integrimin e personelit vendas e realizimin e fushatave informuese, trajnimin, asistencën teknike, ligjore, etj., do të financohen sërish nga fondi dhuratë, sipas planit të veprimtarisë që do të përpilohet nga ETF dhe miratohet nga MESH e nga MPJI-DPBZH.

L I G J

Nr. 9528, datë 11.5.2006

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE ARTIGIANCASSA S.P.A. PËR PROGRAMIN E ZHVILLIMIT TË SEKTORIT PRIVAT, NËPËRMJET MBËSHTETJES SË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME DHE SIGURIMIT TË ASISTENCËS TEKNIKE PËR TO”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa S.P.A. për programin e zhvillimit të sektorit privat, nëpërmjet mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sigurimit të asistencës teknike për to”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4891, datë 2.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE FINANCIARE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË
PËRFAQËSUAR PREJ MINISTRISË SË FINANCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
ARTIGIANCASSA S.P.A
Euro 27 500 000, 00
PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT, NËPËRMJET MBËSHTETJES SË
SME-VE DHE ASISTENCËS TEKNIKE TË NEVOJSHME

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përfaqësuar nga Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë (këtu dhe më tej referuar si “Huamarrësi”), në njëzënë anë,
dhe

-Artigiancassa S.P.A., Cassa per il Credito alle Imprese Artigiane S.p.A., Gruppo Bancario BNL, e listuar në Regjistrin e Bankave, me kapital aksionar prej 35 000 000,00 euro, me seli në Romë, Via Crescenzo del Monte 25, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive, me kod fiskal nr.01158450583 dhe me TVSH nr.00968081000 (këtu dhe më tej referuar si “Artigiancassa”), si administrator, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave të Republikës së Italisë, i Fondit Qarkullues për Bashkëpunim Zhvillimi, të krijuar në përputhje me nenin 26 të ligjit italian nr.227 të 24 majit 1977, dhe më tej referuar në nenin 6 të ligjit italian nr.49 të 26 shkurtit 1987, përfaqësuar nga z.Stefano Gatti, në anën tjetër,

(Artigiancassa dhe Huamarrësi, së bashku, (këtu dhe më tej referuar si “Palët”), kanë vendosur të hyjnë në këtë Marrëveshje financiare

Neni 1
Përkufizime

Në këtë Marrëveshje dhe në shtojcat e saj, termat në vazhdim do të kenë kuptimet që vijojnë:

- “Njohja e të Qenit në Borxh” do të thotë deklarimi, të cilit i bëhet referencë sipas nenit 10, me të cilin Huamarrësi merr përsipër, në favor të Artigiancassa, të rimburojë njëkohësisht kapitalin së bashku me interesin, të cilët janë detyrim sipas Huasë së Butë;

“AGF” do të thotë fondi shqiptar i garancisë i krijuar nga huaja prej 2 500 000,00 euro ofruar Qeverisë Shqiptare dhe i kredituar në një llogari të posaçme të hapur pranë Bankës së Shqipërisë. Ky fond do të përdoret me qëllim uljen e garancive që bankat private tregtare lokale u kërkojnë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

- “Marrëveshje” do të thotë Marrëveshja financiare në fjalë, pjesa hyrëse dhe shtojcat e saj, të cilat janë pjesë integrale të vetë asaj;

- “Kompani audituese” do të thotë një kompani prestigjioze ndërkombëtare në fushën e auditimit (verifikimit dhe kontrollit) financiar. Kjo kompani do të përzgjidhet nga ETF (Fondacioni European i Trajnimeve) për realizimin e kontrollit financiar dhe administrativ të dokumenteve dhe të procedurave që lidhen me programin në përputhje me atë çka thuhet në nenin 5;

- “CLSC” do të thotë Komiteti i Koordinimit të Lehtësimit të Linjës së Kredisë, aktiviteti i të cilit është i përshkruar në marrëveshjen për programin (neni 6.4 dhe shtojca 1.2);

- “ETF” do të thotë Fondacioni European i Trajnimeve, aktiviteti i së cilës është përshkruar në marrëveshjen për programin (neni 6.6 dhe shtojca 1.2);

- “Raport financiar” do të thotë raportet financiare, të vërtetuara nga Kompania e Auditimit të publikuar nga Ministria Shqiptare e Ekonomisë (METE) dhe nga Bordi për Administrimin dhe Mbikëqyrjen e fondeve (FSMB);

- “FSMB” do të thotë Bordi për Administrimin dhe Mbikëqyrjen e Fondeve, aktiviteti i të cilit është përshkruar në marrëveshjen për programin (neni 6.3 dhe shtojca 1,2);

- “Periudha e faljes (Grace)” do të thotë periudha që zgjat 216 muaj, që fillon nga data e lëvrimin të parë të huasë në llogarinë e posaçme;

- “Autoritetet Kompetente Italiane”, do të thotë Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe/ose Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë dhe/ose ndonjë ent tjetër i Republikës së Italisë, i emëruar për qëllime të kësaj Marrëveshjeje;
- “MPJ/DPBZH” do të thotë Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë-Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim Zhvillimi;
- “MEF” do të thotë Ministria e Ekonomisë dhe e Financave të Republikës Italiane;
- “METE” do të thotë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë;
- “MF” do të thotë Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë;
- “PLCB” do të thotë Bankat Tregtare Private Lokale, që në bazë të Marrëveshjes së huasë me METE, do të financojnë SME-të;
- “Programi” do të thotë projekti i lidhur me zhvillimin e sektorit privat, nëpërmjet mbështetjes të SME-ve dhe asistencës teknike që lidhet me to, që do të financohet nga kjo hua e butë në përputhje me marrëveshjen për programin dhe me këtë Marrëveshje financiare për të cilën është rënë dakord;
- “Marrëveshja për programin” do të thotë Marrëveshja e nënshkruar në datën 21 qershor 2005 midis Qeverisë së Republikës Italiane, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës Shqiptare të përfaqësuar nga Ministria e Financave për realizimin e programit;
- “Njësia e Zbatimit të Projektit (NJZP)” do të thotë njësia teknike e krijuar pranë Ministrisë shqiptare të Shëndetësisë e cila do të ofrojë koordinimin e funksioneve teknike dhe menaxheriale, të nevojshme për realizimin e programit;
- “SME-të” janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, projektet e të cilave do të financohen me huanë (25 000 000,00 euro) e akorduar;
- “Hua e Butë” do të thotë financimi, të cilin, Artigiancassa, do të japë sipas termave dhe kushteve të parashikuara në nenin 2 dhe në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës Italiane, dhe mbi propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Kjo kredi është e ndarë në 2 pjesë: 25 000 000 euro për financimin e projekteve të SME-ve dhe 2 500 000 euro për ngritjen e fondit të garancisë (AGF);
- “Llogaria e posaçme” do të thotë llogaria që Huamarrësi ka hapur pranë Bankës së Shqipërisë në të cilën do të bëhet derdhja e kredisë me këste. Shuma prej 25 000 000 euro do të derdhet në një llogari të posaçme për financimin e projekteve të SME-ve, kurse shuma prej 2 500 000 euro do të derdhet në një llogari të posaçme dhe do të përdoret për ngritjen e fondit shqiptar të garancisë (AGF);
- “Kontrata/kontratat e furnizimit” do të thotë kontrata (at) tregtare që kanë të bëjnë me furnizimin e mallrave dhe/ose shërbimeve nga ana e eksportuesve italianë tek importuesit shqiptarë, të lidhura me realizimin e programit.

Neni 2

Pjesa hyrëse

2.1 Përmes marrëveshjes së njohur si “Marrëveshja Qeveritare” (këtu dhe më tej referuar si “Marrëveshja Qeveritare”) e nënshkruar më 17 maj 2004 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Qeverisë së Republikës Italiane, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, kjo e fundit është angazhuar të financojë programin përmes një huaje të butë deri në një shumë maksimale prej 27 500 000,00 (njëzet e shtatë milionë e pesëqind mijë) euro.

2.2 Përmes kësaj Marrëveshjeje, palët kanë ndërmend: (i) të zbatojnë parashikimet financiare, lidhur me Huanë e Butë, të caktuara më parë në Marrëveshjen Qeveritare; dhe (ii) të rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me Marrëveshjen Qeveritare.

2.3 Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Qeverisë së Republikës së Italisë, bazuar në propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë, me dekretin nr.13176, datë 3 shkurt 2006 ka autorizuar Artigiancassa t'i japë Huamarrësit një hua të butë sipas termave dhe kushteve të caktuara më parë në nenet 3 dhe 6 të kësaj Marrëveshjeje (këtu dhe më tej referuar si "Huaja e Butë") për qëllimin e financimit të programit.

2.4 Huamarrësi, mbështetur në marrëveshjen e programit, njeh se METE do të jetë përgjegjëse për përcaktimin e marrëveshjeve me institucionet kompetente dhe do të nënshkruajë kontratat përkatëse. Përveç kësaj, METE do të jetë përgjegjëse në emër të Huamarrësit, për përdorimin e fondeve, si dhe për shlyerjen e kredisë sipas procedurave dhe modaliteteve të përcaktuara për këtë qëllim në këtë Marrëveshje financiare.

Neni 3 **Huaja e Butë**

3.1 Artigiancassa i jep Huamarrësit dhe Huamarrësi me këtë pranon Huanë e Butë sipas kushteve që vijojnë:

- Shuma: 27 500 000,00 (njëzet e shtatë milionë e pesëqind mijë) euro;
- Kohëzgjatja: 38 vjet;
- Periudha e faljes (grace): 216 muaj duke filluar nga data e lëvrimit të parë;
- Ripagimi: me 40 (dyzet) këste të njëpasnjëshme, të barabarta, çdo gjashtëmuaj, të principalit, i pari i të cilëve kthehet në detyrim për t'u paguar 216 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë) muaj nga data e lëvrimit të parë;
- Norma e interesit: nominale, vjetore, 0,00% (zero pikë zero për qind);
- Qëllimi i huasë: financimi i zhvillimit të sektorit privat nëpërmjet një kredie në mbështetje të SME-ve dhe të asistencës teknike. Huaja është e ndarë në dy pjesë: shuma prej 25 000 000 euro do të përdoret për financimin e projekteve të SME-ve, kurse shuma prej 2 500 000 për ngritjen e një fondi garancie (AGF).

3.2 Huaja e Butë do të përdoret për përfitimin e mallrave dhe shërbimeve me origjinë italiane. Një shumë maksimale prej 30% (tridhjetë për qind) e shumës së lidhur me Huanë e Butë prej 25 000 000,00 euro, mund të përdoret për të mbuluar koston lokale dhe importet e mallrave dhe shërbimeve me origjinë nga vende të tjera në zhvillim.

Kontratat e furnizimit do të jenë të përcaktuara në euro.

3.3 Huaja e Butë nuk mund të përdoret për të financuar:

- taksat lokale, detyrimet doganore, TVSH-në;
- kapitalin likuid-qarkullues (me përjashtim të shumës fillestare të përdorur për fillimin);
- *joint ventures*, për aktivitete financiare dhe tregtare të përkohshme;
- investime në sektorin e kohës së lirë, në armë, drogë dhe alkool, në duhan, në prodhim dhe në produkte të ndaluara për importim dhe eksportim nga Bashkimi Europian në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

3.4 Huaja e Butë do të jetë e disponueshme në përputhje me termat dhe kushtet e caktuara më parë në këtë Marrëveshje.

3.5 Huaja për financimin e projekteve të SME-ve do të derdhet me 3 këste në përputhje me procedurat e përshkruara në nenin 7; huaja për financimin e fondit shqiptar të garancisë (AGF) do të derdhet me 2 këste në përputhje me procedurat e përshkruara në nenin 8.

3.6 Interesat e rritur mbi shumat e mbajtura në llogaritë e posaçme ose në llogari të tjera të hapura në një bankë të nivelit të dytë sipas kushteve të Marrëveshjes do të përdoren për financimin e programit dhe për shërbimin e borxhit.

Neni 4 **Hyrja në fuqi e Marrëveshjes financiare**

4.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi sapo Artigiancassa të ketë marrë dokumentet e mëposhtme:

Nga Huamarrësi:

i) një deklaratë nga autoriteti kompetent i Qeverisë së Shqipërisë, i cili provon autoritetin e Huamarrësit për të nënshkruar, në emër dhe për llogari të Qeverisë Shqiptare, këtë Marrëveshje nga një person plotësisht i autorizuar, në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe me efekt të plotë në Shqipëri dhe të marrë përsipër detyrimet që rrjedhin prej kësaj Marrëveshjeje;

ii) caktimin me shkrim, nga autoriteti kompetent i Huamarrësit, të personit/personave plotësisht të autorizuar për të nënshkruar këtë Marrëveshje (e vërtetuar nga Ambasada Italiane në Tiranë), kërkesën për financim të kontratave të furnizimit sipas formularit në shtojcën A, si dhe “Njohjen e të Qenit Borxh”, sipas formularit në shtojcën B, së cilës i bëhet referencë sipas nenit 10 më poshtë. Ky caktim do të specifikojë emrin dhe pozitën e personit/personave dhe do të përmbajë të përditësuar depozitimin e nënshkrimeve të tyre. Çdo modifikim i saj (nëse do të ketë) do të transmetohet në kohë nga Huamarrësi tek Artigiancassa.

iii) një deklaratë që certifikon hapjen e llogarisë së posaçme siç edhe specifikohet në përkufizimet e lartpërmendura.

4.2 Artigiancassa do të njoftojë Huamarrësin dhe Ministrinë e Jashtme Italiane, me letër ose me faks, për datën në të cilën kjo Marrëveshje do të bëhet efektive sapa të ketë marrë, dhe në mënyrë plotësisht të kënaqshme dokumentacionin e lartpërmendur, e cila do të ndiqet prej një konfirmimi me letër.

Neni 5

Kompania audituese

5.1 ETF do të bëjë seleksionimin dhe do t'i besojë një kompanie audituese detyrën e certifikimit të raporteve financiare të publikuara nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë dhe nga FSMB.

5.2 Certifikimi nga ana e kompanisë audituese: i) do të përqendrohet në raportet financiare dhe teknike që Huamarrësi nëpërmjet METE u dërgon MPJ-DPBZH dhe ii) konsiderojë rregullsinë dhe përputhshmërinë me kushtet e vëna në këtë Marrëveshje për çdo transfertë financiare që lidhet me huanë në fjalë.

Neni 6

Afatet për lëvrimin e Huasë së Butë për financimin e projekteve të SME-ve

6.1 Periudha e lëvrimit të Huasë së Butë është 35 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e lëvrimit të parë. Kjo periudhë mund të zgjatet nga ana e Artigiancassa. Artigiancassa nuk mund të zgjasë periudhën e lëvrimit në rast se Huamarrësi ose Autoritetet Kompetente Italiane nuk bien dakord për një zgjatje të tillë dhe kanë njoftuar me shkrim për këtë Artigiancassa, të paktën 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para skadimit të periudhës së lëvrimit.

6.2 Në rastin kur periudha e lëvrimit ka skaduar dhe është e pazgjatshme, Artigiancassa, pasi ta ketë konsultuar këtë me Autoritetet Kompetente Italiane, do të informojë Huamarrësin për anulimin e angazhimit të Artigiancassa, përsa i takon fondeve të papërdorura.

Neni 7

Kushtet dhe procedurat për lëvrimin e Huasë së Butë për financimin e projekteve të SME-ve

7.1 Kur kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi, Artigiancassa do të bëjë zbatimin e kërkesës për lëvrim të huasë, në përputhje me çfarë është parashikuar për këtë. Huaja do të jepet me 3 këste, kësti i parë prej 5 000 000,00 (pesë milionë) euro, i dyti 10 000 000,00 (dhjetë milionë) euro dhe i treti 10 000 000,00 (dhjetë milionë) euro.

Interesat e rritur mbi shumat e mbajtura në llogaritë e posaçme ose në llogari të tjera të hapura në një bankë të nivelit të dytë sipas kushteve të Marrëveshjes do të përdoren për financimin e programit dhe për shërbimin e borxhit.

7.2 Çdo kërkesë për lëvrim të huasë do të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve duke filluar nga dita e marrjes së kërkesës nga Artigiancassa.

7.3 Kërkesa për lëvrimin e kështit të parë të huasë, e bërë nga METE sipas shtojcës A për shumën prej 5 000 000,00 (pesë milion) euro do të derdhet pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe të marrjes:

a) nga MPJ-DPBZH e komunikatës së lëshuar nga METE në lidhje me ngritjen dhe aftësinë për të funksionuar të strukturave të përshkruara në nenin 6 të PA-së.

Kopje të këtyre komunikimeve do t'i dërgohen Artigiancassa nga MPJ-DPBZH.

7.4 Kërkesa për lëvrimin e kështit të dytë të huasë, e bërë nga METE sipas shtojcës A për shumën 10 000 000,00 (dhjetë milionë) euro do të derdhet pas miratimit nga MPJ-DPBZH dhe njohjes nga ana e Artigiancassa e raportit financiar, të publikuar nga METE, të vërtetuar nga kompania audituese dhe të dërguar nga MPJ-DPBZH me të gjitha dokumentet e duhura (kontratat, faturat, faturat e shpërndarjes). Raporti financiar do të mbulojë të paktën 4 000 000,00 (katër milionë) euro të kështit të parë të derdhur. MPJ-DPBZH do të informojë METE, për dijeni Huamarrësin dhe Artigiancassa në lidhje me rezultatet e kontrollit brenda 20 ditëve nga data e marrjes së raportit financiar.

7.5 Nëse disa nga shpenzimet e përfshira në raportin financiar nuk do të certifikohen nga kompania audituese dhe/ose nuk do të miratohen nga MPJ-DPBZH, atëherë kësti i dytë i huasë do të derdhet vetëm pasi METE të ketë derdhur të njëjtën shumë që korrespondon me shpenzimet jo të miratuara.

7.6 Kërkesa për lëvrimin e kështit të tretë të huasë, e bërë nga METE sipas shtojcës A për shumën prej 10 000 000,00 (dhjetë milionë) do të derdhet pas miratimit nga MPJ-DPBZH dhe njohjes nga ana e Artigiancassa të raportit financiar të publikuar nga FSMB, të vërtetuar nga kompania audituese dhe të dërguar MPJ-DPBZH me të gjitha dokumentet e duhura (kontratat, faturat, faturat e shpërndarjes). Raporti financiar do të mbulojë 12 000 000,00 (dymbëdhjetë milionë) euro të kështit të parë të derdhur. MPJ-DPBZH do të informojë METE, për dijeni Huamarrësin dhe Artigiancassa në lidhje me rezultatet e kontrollit brenda 20 ditëve nga data e marrjes së raportit financiar.

7.7 Nëse disa nga shpenzimet e përfshira në raportin financiar nuk do të certifikohen nga kompania audituese dhe/ose nuk do të miratohen nga MPJ-DPBZH, atëherë kësti i tretë i huasë do të derdhet vetëm pasi METE të ketë derdhur të njëjtën shumë që korrespondon me shpenzimet jo të miratuara.

7.8 Brenda 12 muajve nga derdhja e kështit të fundit, METE do të vendosë që të vërë bashkë një shumë më të madhe se 22 000 000,00 euro dhe të lëshojë një raport financiar të vërtetuar nga kompania audituese dhe dërguar MPJ-DPBZH. Përdorimi i shumës së mbetur do të jetë objekt i miratimit nga ana e MPJ-DPBZH i raportit financiar të përmendur brenda 20 ditëve nga data e marrjes së tij. MPJ-DPBZH do të informojë METE, për dijeni Huamarrësin dhe Artigiancassa në lidhje me rezultatet e këtij verifikimi.

7.9 Nëse disa nga shpenzimet e përfshira në raportin financiar nuk do të certifikohen nga kompania audituese dhe/ose nuk do të miratohen nga MPJ-DPBZH, atëherë kësti i tretë i huasë do të derdhet vetëm pasi METE të ketë derdhur të njëjtën shumë që korrespondon me shpenzimet jo të miratuara.

7.10 Pas përdorimit të kësaj shume të mbetur, ose brenda 24 muajve nga data e lëvrimin të kështit të fundit, METE do të japë një raport financiar të vërtetuar nga kompania audituese dhe të dërguar MPJ-DPBZH. Brenda 20 ditëve nga data e marrjes së raportit financiar, MPJ-DPBZH do të informojë METE, për dijeni Huamarrësin dhe Artigiancassa në lidhje me rezultatet e këtij verifikimi.

7.11 METE në mënyrë të pakthyeshme merr përsipër që t'i japë Artigiancassa shumat që korrespondojnë me shpenzimet jo të vërtetuara nga kompania audituese dhe/ose jo të miratuara nga MPJ-DPBZH.

7.12 Nëse ndonjë nga shumat që Artigiancassa e lëvroi Huamarrësit nuk përdoret brenda 24 muajve nga data e lëvrimit të fundit, atëherë këto shuma menjëherë do t'i kthehen Artigiancassa nga ana e Huamarrësit.

7.13 Ky transferim i fondeve do të bëhet pa vonesë brenda një muaji nga data e komunikimit të MPJ-DPBZH me Huamarrësin.

Neni 8

Kushtet dhe procedurat për lëvrimin e Huasë së Butë për financimin e fondit shqiptar të garancisë (AGF)

8.1 Kur kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi, Artigiancassa do të ekzekutojë kërkesën për lëvrim të huasë, në përputhje me çfarë është parashikuar për këtë. Huaja do të jepet me 2 këste, kësti i parë prej 500 000,00 (pesëqind mijë) euro dhe i dyti 2 000 000,00 (dy milionë) euro në një llogari të posaçme të hapur nga Huamarrësi pranë Bankës së Shqipërisë. Interesat e rritur për shumat në llogarinë e posaçme do të përdoren për të financuar programin.

8.2 Çdo kërkesë për lëvrim të huasë do të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve duke filluar nga dita e marrjes së kërkesës nga Artigiancassa.

8.3 Kërkesa për lëvrimin e kështit të parë, e bërë nga METE sipas shtojcës A për shumën prej 500 000,00 (pesëqind mijë) euro do të derdhet pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe të marrjes:

b) nga ana e MPJ-DPBZH e komunikatës së lëshuar nga METE në lidhje me ngritjen dhe aftësinë për të funksionuar të strukturave të përshtuara në nenin 6 të PA-së;

c) nga ana e Artigiancassa e miratimit nga ana e MPJ-DPBZH dhe CLSC të draftit mbi planin e administrimit pilot (Manuale delle Procedure) të bërë nga ETF.

Kopje të komunikimeve të mësipërme do t'i dërgohen Artigiancassa-ës nga ana e MPJ-DPBZH-së.

8.4 Kërkesa për lëvrimin e kështit të dytë, e bërë nga METE sipas shtojcës A për shumën 2 000 000,00 (dy milionë) euro do të derdhet pas periudhës pilot dhe pas miratimit nga MPJ-DPBZH dhe njohjes nga ana e Artigiancassa të raportit financiar, të publikuar nga METE, të vërtetuar nga kompania audituese dhe të dërguar MPJ-DPBZH me të gjitha dokumentet e duhura.

MPJ-DPBZH do të informojë Huamarrësin dhe Artigiancassa në lidhje me rezultatet e kontrollit brenda 20 ditëve nga data e marrjes së raportit financiar.

8.5 Nëse disa nga garancitë e përfshira në raportin financiar nuk do të certifikohen nga kompania audituese dhe/ose nuk do të miratohen nga MPJ-DPBZH, atëherë kësti i dytë i huasë do të derdhet vetëm pasi METE të ketë derdhur të njëjtën shumë që korrespondon me shpenzimet jo të miratuara.

8.6 Pas përdorimit tërësor të kësaj shume, ose brenda 24 muajve nga data e lëvrimit të kështit të fundit, METE do të japë një raport financiar të vërtetuar nga kompania audituese dhe të dërguar MPJ-DPBZH. Brenda 20 ditëve nga data e marrjes së raportit financiar, MPJ-DPBZH do të informojë METE për dijeni Huamarrësin dhe Artigiancassa në lidhje me rezultatet e këtij verifikimi.

8.7 METE në mënyrë të pakthyeshme merr përsipër që t'i japë Artigiancassa shumat që korrespondojnë me garancitë jo të vërtetuara nga kompania audituese dhe/ose jo të miratuara nga ana e MPJ-DPBZH.

8.8 Nëse ndonjë nga shumat që Artigiancassa i lëvroi Huamarrësit nuk përdoret brenda 24 muajve nga data e lëvrimit të fundit, atëherë këto shuma menjëherë do t'i kthehen Artigiancassa nga ana e Huamarrësit.

8.9 Ky transferim i fondeve do të bëhet pa vonesë brenda një muaji nga data e komunikimit të MPJ-DPBZH me Huamarrësin.

Neni 9 **Pagimi i Huasë së Butë**

9.1 Menjëherë pas lëvrimit të kështit të parë në llogarinë e posaçme, Artigiancassa do t'i japë (me shkrim) Huamarrësit programin për pagimin e borxhit për shumat e lëvruara. Pas lëvrimit të dytë e kështu me radhë, Artigiancassa do t'i japë Huamarrësit një program të ri për pagimin e huasë në lidhje me lëvrimin e fundit. Secili program për pagimin e huasë i kompiluar sipas kushteve të dhëna në nenin 9.2 dhe në nenin 9.3 do të pranohet me shkrim nga Huamarrësi.

9.2 Çdo shumë që Artigiancassa derdh në llogarinë e Huamarrësit do të paguhet në 40 këste 6-mujore të barabarta dhe të njëpasnjëshme (këtej e në vijim si "Këstet kryesore") i pari prej të cilave bie 216 muaj pas datës së lëvrimit të kështit të parë të huasë. Artigiancassa do t'i dërgojë Huamarrësit programin e pagimit të huasë në përputhje me nenin 9.1.

9.3 Huamarrësi merr përsipër që të bëjë të gjitha pagesat që lindin nga kjo marrëveshje sikundër edhe ato që parashikon formulari i Njohjes së të Qenit Borxh pa vonesë nga data e caktuar, për shumat korresponduese në euro, në favor të Artigiancassa ose të personave të autorizuar për këtë. Këto shuma do të derdhen pa zbritje në lidhje me çfarëdolloj banke dhe/ose kursi këmbimi dhe/ose takse, si dhe pa lajmërim për këtë nga Artigiancassa ose personat e autorizuar.

Neni 10 **Lëshimi i "Njohjes së të Qenit në Borxh"**

10.1 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e fundit e skadimit të lëvrimit të Huasë së Butë, i caktuar në parë në nenin 6.1, Huamarrësi do të lëshojë për Artigiancassa, "Njohjen e të Qenit në Borxh", të nënshkruar rregullisht dhe të sigluar në çdo faqe, sipas formularit në shtojcën B.

10.2 Grafiku i ripagimit, i përcaktuar më parë në "Njohjen e të Qenit në Borxh", do të kompletohet duke mbledhur të gjitha këstet e principalit të pamaturuara ende, dhe këstet që janë maturuar, por nuk janë paguar ende në datën e lëshimit të "Njohjes së të Qenit në Borxh", e parashikuar në grafikun përkatës të ripagimit për çdo lëvrim, në përputhje me parashikimet e nenit 9.1.

10.3 Artigiancassa do të depozitojë "Njohjen e të Qenit në Borxh", për arkivim dhe administrim, dhe kohë pas kohe do të evidentojë në "Njohjen e të Qenit në Borxh" çdo ripagesë të principalit sapo të gjitha pagesat e parashikuara në "Njohjen e të Qenit në Borxh" të jenë kryer, Artigiancassa, do t'i kthejë Huamarrësit, të firmosur rregullisht "Njohjen e të Qenit në Borxh", si provë e kryerjes së ripagimit.

Neni 11 **Angazhimi i Huamarrësit**

11.1 Angazhimi i Huamarrësit, për të paguar shumat detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje dhe sipas "Njohjes së të Qenit në Borxh" lidhur me të, është i pavarur, absolut, i pakushtëzuar dhe i pakthyeshëm.

Neni 12 **Rreziket dhe forca madhore**

12.1 Në rast rreziku ndaj zbatimit të programit për shkak të forcave madhore (të tilla si: lufta, përmytjet, zjarri, tërmeti, konflikte pune dhe greva, veprime të qeverisë, vështirësive të papritura të transportit, punës dhe shkaqe të tjera), do të zbatohen dispozitat e specifikuara në Marrëveshjen Qeveritare. Artigiancassa do të ndjekë udhëzimet e Autoriteteve Kompetente Italiane në lidhje me veprimtarinë e programit.

Neni 13
Pezullimi i lëvrimeve

13.1 Gjatë periudhës së lëvrimit të Huasë së Butë, Artigiancassa ruan të drejtën të pezullojë çdo kërkesë për lëvrim sipas neneve 7 dhe 8, në rastin e ndonjë dështimi për të vepruar kundrejt Artigiancassa, sipas kësaj Marrëveshjeje apo huash të tjera financiare të dhëna nga Qeveria e Republikës së Italisë për Qeverinë ose për Bankën Qendrore ose për Agjenci Shtetërore të Republikës së Shqipërisë në zbatim të nenit 6 të ligjit nr.38 të 9 shkurtit 1979 dhe të nenit 6 të ligjit nr.49 të 26 shkurtit 1987 të Republikës së Italisë, me ndryshimet e pësuara. Artigiancassa do të informojë, rast pas rasti, Huamarrësin për një pezullim të tillë.

13.2 Artigiancassa do të ekzekutojë çdo kërkesë për lëvrim siç është parashikuar në nenet 7 dhe 8, në rast se shumtë korresponduese janë bërë të disponueshme nga Autoritetet Kompetente Italiane. Artigiancassa nuk do të quhet përgjegjëse kundrejt Huamarrësit në rast se shumtë për t'u lëvruar më kuadrin e Huasë së Butë, nuk do të jenë bërë të disponueshme nga Autoritetet Kompetente Italiane.

Neni 14
Interesvonesa

14.1 Nëse për ndonjë arsye, çfarëdoqoftë, Artigiancassa nuk merr shumtë detyrim për principalin dhe/ose interesin në datën kur ato janë detyrim për t'u paguar, Huamarrësi do të jetë i detyruar t'i paguajë Artigiancassa, mbi shumtë e përmendur, interesvonesa, që nga data e detyrimit deri në datën e kreditimit efektiv në favor të Artigiancassa ose të personit/personave të caktuar për këtë.

14.2 Ky interesvonesë, që rrjedh nga dështimi për të vepruar, do të përlogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë me një normë prej 2,5% (dy presje pesë për qind) për periudhën vijuese menjëherë pas periudhës prej 35 (tridhjetë e pesë) ditësh kalendarike, nga data origjinale e detyrimit, deri në datën e kreditimit efektiv të Artigiancassa. Ky i dyti, do të përditësohet nga Autoritetet Kompetente Italiane.

14.3 Rishikimi ka për qëllim sjelljen e interesvonesës në të njëjtën linjë me, dhe për asnjë arsye jo më të lartë se Norma e Referencës së Interesit Tregtar (NRIT) e publikuar çdo muaj nga OECD-ja.

Neni 15
Taksat

15.1 Çdo taksë në fuqi në të tashmen apo në të ardhmen që mund të jetë e detyrueshme për pagesë në Shqipëri, për ndonjë arsye çfarëdo, lidhur me këtë Marrëveshje dhe me "Njohjen e të Qenit në Borxh", do të përballohet ekskluzivisht nga Huamarrësi.

15.2 Çdo taksë detyrim për t'u paguar në Itali, lidhur me këtë Marrëveshje, nuk do të përballohet nga Huamarrësi.

15.3 Artigiancassa deklaron se do të përfitojë nga statusi fiskal, i parashikuar sipas nenit 19 të dekretit nr.601 të 29 shtatorit 1973 të Presidentit të Republikës, me ndryshimet e pësuara.

Neni 16
Ligji i zbatueshëm

16.1 Kjo Marrëveshje do të udhëhiqet e interpretohet në përputhje me ligjin italian.

Neni 17
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

17.1 Palët këtu, do të bëjnë përpjekje për të zgjidhur në mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë interpretimit dhe/ose zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

17.2 Nëse këto përpjekje nuk do të çojnë brenda një periudhe kohe të arsyeshme në një zgjidhje të mosmarrëveshjes, atëherë mosmarrëveshja do të zgjidhet në nivel qeveritar.

17.3 Nëse edhe kjo përpjekje do të dështojë ose (nëse është tentuar) ajo nuk përfundon me një rezultat të kënaqshëm, të gjitha mosmarrëveshjet që lindin prej ose lidhen me këtë Marrëveshje, do të zgjidhen përfundimisht, sipas rregullores së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, Francë nga një Gjykatë Arbitrazhi me tre arbitra:

- një arbitër i caktuar nga Huamarrësi;
- një arbitër i caktuar nga Artigiancassa;
- arbitri i tretë caktohet nga arbitrat e lartpërmendur, ose në rast të mosrënies dakord të tyre, prej kryetarit të Dhomës Tregtare Ndërkombëtare, Paris.

17.4 Nëse Huamarrësi ose Artigiancassa nuk caktojnë arbitrin e tyre brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga kërkesa e palës tjetër, ky arbitër do të caktohet nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

17.5 Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit, e cila do të vendosë sipas ligjit të Republikës së Italisë do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim pa kushte nga të dyja palët pa asnjë mundësi për ta apeluar.

17.6 Asnjë mosrënie dakord dhe asnjë mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të këtushme, nuk mundet të pezullojë detyrimin e Huamarrësit për të paguar, në datat përkatëse, të rëna dakord, të gjitha shumat detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, veçanërisht, të gjitha shumat e rezultuara nga grafikët e ripagimit të caktuara më parë në nenin 7 më sipër dhe nga “Njohja e të Qenit në Borxh” e lidhur me të.

Neni 18
Komunikimet

18.1 Njoftimet për t’u bërë në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të adresohen si vijon:

Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 250264; faks: +355 4 228494

Artigiancassa S.P.A
Via Crescenzo del Monte-00153
Romë, Itali
Tel: 0039 06 58455414-560-561
Faks: 0039-06-5845466

Neni 19
Tekstet origjinale të Marrëveshjes financiare

19.1 Kjo Marrëveshje financiare firmoset në tre ekzemplarë origjinalë në gjuhën angleze.

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë,
i përfaqësuar nga Ministria e financave të Republikës së
Shqipërisë
Firmosur në.....më datë.....

Artigiancassa
Firmosur në.....më datë.....

(MODEL-FORMULARI I KËRKESËS PËR LËVRIM TË HUASË)

Shtojca A

Nga ...(METE)

Për: Artigiancassa S.p.A

Marrëveshje financiare për shumën.....euro të firmosur nga ne.....në datë.....dhe nga Artigiancassa S.p.A.....në datë.....

Në përputhje me nenin.....të Marrëveshjes financiare të përmendur më lart, me këtë dokument kërkohet që të akreditohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve në llogarinë e posaçme nr.ose..... dhe të hapur pranë Bankës.....shuma e shprehur në euro.....(.....) me kusht që fondet monetare janë bërë të disponueshme nga ana e Autoriteteve Italiane Kompetente.

Fondet e lëvuara nga Ju në llogarinë e posaçme do të përdoren për zbatimin e programit.

Me këtë dokument marrim përsipër në mënyrë të pakushtëzuar dhe të pakthyeshme që të paguajmë shumën e shprehur në euro.....të akredituar nga Ju në llogarinë e posaçme, në përputhje me afatet dhe kushtet e shtruar në Marrëveshjen financiare të përmendur më lart.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e fundit e skadencës së lëvrimin të huasë, ne marrim përsipër që t'i dërgojmë Artigiancassa-ës S.p.A një dokument të njohjes së borxhit për të gjitha shumat e lëvuara në kuadrin e Marrëveshjes financiare të përmendur më lart.

Dokumenti i njohjes së borxhit do të jetë në formën e paraqitur në shtojcën B të Marrëveshjes financiare të përmendur më lart.

(MODEL-FORMULARI I “NJOHJES SË TË QENIT NË BORXH”)

Shtojca B

.....(Huamarrësi)

Nr.....

Vendi dhe data e lëshimit

.....

Referuar Marrëveshjes financiare ndërmjet.....(Huamarrësi), i cili verpon në emër dhe për llogari të Qeverisë së.....dhe Artigiancassa, e nënshkruar në.....më.....dhe në.....më..... (Huamarrësi) njih marrjen e shumave që vijnë nga Artigiancassa:

.....më.....

.....më.....

.....më.....

Për këtë.....(Huamarrësi), me anë të kësaj, deklaron pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme, të jetë debitor ndaj Artigiancassa, si administratore e Fondit Qarkullues për Bashkëpunim e Zhvillim, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF) të Italisë-me seli në Romë (Itali), Via Crescenzo del Monte 25, për shumën principale prej(.....) euro, të cilën ai merr përsipër ta ripaguajë në(.....) këste të barabarta gjashtëmujore, të njëpasnjëshme, i pari i të cilëve do të bëhet detyrim për t'u paguar më.....dhe i fundit më.....sipas grafikut të ripagimit, të caktuar më parë, këtu dhe më poshtë:

.....(Huamarrësi) do të ripaguajë këstet e principalit dhe interesin e parashikuar në këtë “Njohje të Qenit në Borxh”, duke akredituar shumat përkatëse në euro, në datën e detyrimit, e rënë dakord, në favor të Artigiancassa, ose të personit/personave të caktuar për këtë, me zyrën e degës në Romë të.....të zhveshur nga çdo tarifë shërbimi e bankës dhe/ose këmbimi.

Nëse, zyra e degës në Romë e.....për ndonjë arsye çfarëdo, duke përfshirë edhe për arsye jashtë kontrollit të Huamarrësit, nuk merr në datën e detyrimit, shumat detyrim për principalin dhe interesin, të parashikuara në “Njohjen e të Qenit në Borxh”, Huamarrësi do të jetë i detyruar t’i paguajë zyrës së degës në Romë të....., interesvonesë mbi këto shuma, që nga data e detyrimit deri në datën e kreditimit efektiv në favor të Artigiancassa ose të personit/personave të caktuar për këtë.

Ky interesvonesë do të përlllogaritet me normën zero për periudhën e 35 ditëve që vijojnë menjëherë nga data origjinale e detyrimit dhe më tej, me normën 2,5% (dy presje pesë për qind) deri në datën e kreditimit efektiv në favor të Artigiancassa.

Ky interes i fundit, i lidhur me dështimin për të vepruar, do të përditësohet nga Autoritetet Kompetente Italiane.

.....

Artigiancassa do të shënojë kohë pas kohe, në këtë “Njohje të të Qenit në Borxh, çdo pagesë të principalit dhe të interesit.

Menjëherë sapo të jenë kryer të gjitha pagesat e listuara në grafikun e ripagimit, i caktuar më parë dhe këtu e në vijim, kjo “Njohje e të Qenit në Borxh”, do t’i kthehet.....(Huamarrësi) përmes Bankës.....

Kjo “Njohje e të Qenit në Borxh” është lëshuar në zbatim të Huasë së Butë prej (.....) euro, dhënë në përputhje me nenin 6 të ligjit nr.49 të 26 shkurtit 1987.

GRAFIKU I RIPAGIMIT

Data e maturimit	Këste principal	Këste interesi	Shuma
a)
b)
c)
d)
1)
2)
3)
4)
5)
6)
7)
8)
9)
10)

(Nënshkrimi i Huamarrësit)

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
 - 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
 - 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
 - 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**
-
- | | | |
|-----------|---|-------------|
| 1. | PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) | 1500 |
| 2. | PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) | 600 |
| 3. | PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).... | 1500 |
| 4. | PËR TAKSAT DHE TATIMET (+suplement 2006) | 1500 |
-
- | | | |
|-----------|---|-------------|
| 1. | TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT..... | 1500 |
| 2. | TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT..... | 2000 |

BOTIME TË REJA

- | | | |
|-----------|---|-------------|
| 1. | PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT | 500 |
| 2. | KODI DOGANOR | 1000 |
| 3. | KODI DETAR | 1000 |

Hyri në shtyp më 12.6.2006
 Doli nga shtypi më 14.6.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Ilar"
 Tiranë, 2006

Çmimi: 150 lekë